| <p style="text-align: center;">Neni 8 Llojet e institucioneve të arsimit të lartë</p> <p>1. Arsimi i lartë në Republikën e Kosovës ofrohet nga Universitetet, Kolegjet Universitare, Kolegjet e Arsimit të Lartë,</p> | <p style="text-align: center;">Article 8 Types of higher education institutions</p> <p>1. Higher Education in the Republic of Kosova is delivered by Universities, University Colleges, Higher Education</p> | <p style="text-align: center;">Član 8 Vrste institucija visokog obrazovanja</p> <p>1. Visoko obrazovanje u Republici Kosovo pružaju Univerziteti, univerzitetski koledži, koledži visokog</p> |

| | | |
|--|---|--|
| <p>Kolegjet Profesionale dhe Shkollat e Larta Profesionale.</p> <p>2. Universitetet:</p> <p>2.1. Universiteti është institucion që ushtron aktivitete të arsimit të lartë, kërkimit shkencor, veprimtarisë artistike dhe profesionale, në një gamë të gjerë të disiplinave dhe jep diploma e grada përfshirë edhe në nivelin e doktoratës në ato disiplina, me synim të nxisë:</p> <p>2.1.1. Përparimin në fushën e njohurive akademike, kërkimit shkencor dhe/ose artistike, në Kosovë, dhe më gjerë;</p> <p>2.1.2. Zhvillimin arsimor, shkencor, kulturor, shoqëror dhe ekonomik të Kosovës, dhe më gjerë;</p> <p>2.1.3. Zhvillimin e shkathtësive dhe kompetencave të nivelit të lartë, dhe</p> <p>2.1.4. Nxitjen e qytetarisë demokratike dhe arritjen e standardeve më të larta në mësimdhënie dhe nxënie.</p> <p>2.2. Statusi “Universitet” mund t’i jepet vetëm institucionit që ofron programe</p> | <p>Colleges, Professional Colleges and Higher Vocational Schools.</p> <p>2. Universities:</p> <p>2.1. A University is an institution that carries out higher education, scientific research, artistic and professional endeavours in a broad range of disciplines and awards diplomas and degrees including at the doctoral level in these disciplines, with a view to foster:</p> <p>2.1.1. The advancement in academic knowledge field, scientific research and/or artistic endeavours, in Kosova, and beyond;</p> <p>2.1.2. The educational, scientific, cultural, social and economic development of Kosova, and beyond;</p> <p>2.1.3. The development of high level skills and competencies, and</p> <p>2.1.4. The stimulation of democratic citizenship and the achievement of the highest standards in teaching and learning.</p> <p>2.2. The status of “University” may be granted only to an institution that offers</p> | <p>obrazovanja, profesionalni koledži i više stručne škole.</p> <p>2. Univerziteti:</p> <p>2.1. Univerzitet je institucija koja sprovodi visoko obrazovanje, naučna istraživanja, umetničke i stručne napore u širokom spektru disciplina i daje diplome i stepene, uključujući na doktorskom nivou u ovim disciplinama, sa ciljem da podstakne:</p> <p>2.1.1. Napredak u oblasti akademskog znanja, naučnih istraživanja i/ili umetničkih poduhvata, na Kosovu, -šire;</p> <p>2.1.2. Obrazovni, naučni, kulturni, socijalni i ekonomski razvoj Kosova, i šire;</p> <p>2.1.3. Razvoj veština i kompetencija na visokom nivou, i</p> <p>2.1.4. Stimulisanje demokratskog građanstva i postizanje najviših standarda nastave i učenja.</p> <p>2.2. „Status Univerziteta“ se može odobriti samo instituciji koja nudi</p> |
|--|---|--|

| | | |
|--|---|---|
| <p>të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor/artistik që përfshijnë së paku pesë (5) fusha të gjera nëpërmjet të cilave ofron programe të akredituara në nivel të doktoratës. Universiteti duhet të ketë së paku njëqindnjëzet (120) anëtarë të personelit akademik me orar të plotë pune dhe së paku gjysma e tyre duhet të kenë titullin më të lartë shkencor dhe duhet të jenë në mënyrë aktive të angazhuar në aktivitete hulumtuese dhe botuese që realizohen në universitet.</p> <p>2.3. Vetëm universitetet publike mund të ofrojnë programe studimi që shpjen në kualifikime për mësimdhënës në nivel parauniversitar. Ministri mban të drejtën ekskluzive të aprovimit ose refuzimit të licencimit për programe të tilla, në bazë të akreditimit të AKA-së.</p> <p>2.3.1. Studimet për mësimdhënës të nivelit të arsimit parashkollor dhe fillor zgjasin së paku katër (4) vite ose 240 ECTS kredi. Vetëm kandidatët që kanë përfunduar gjimnazin dhe që kanë arritur notën mesatare 4.0 ose më shumë gjatë shkollimit të mesëm të lartë dhe kanë arritur së paku 60% të pikëve në provimin e maturës mund të kualifikohen për regjistrim në këto</p> | <p>higher education and scientific/artistic research programmes covering at least five (5) broad disciplines in which it offers accredited programmes at the Doctorate level. A University must have at least one hundred twenty (120) academic staff members working full time and at least half of them must have the highest scientific title and must be actively engaged in research and publication activities carried out at the university.</p> <p>2.3. Only public universities can offer study programs that lead to qualifications for pre-university teachers. The Minister has the exclusive right of approval or denial of licensing for such programmes, on the basis of accreditation by KAA.</p> <p>2.3.1. Studies for teacher of preschool education and primary education last at least four (4) years or 240 ECTS credits. Only candidates who have completed the gymnasium and achieved a grade point average of 4.0 or more in upper secondary education and that achieved at least 60% score of the Matura Exam shall qualify for enrollment in these programs of study;</p> | <p>visoko obrazovanje i naučno/umetničke istraživačke programe koji pokrivaju najmanje pet (5) širokih disciplina u kojima se nude akreditovani programi na nivou doktorata. Univerzitet mora da ima najmanje stotinu dvadeset (120) akademskih članova osoblja koji rade puno radno vreme i najmanje polovina njih mora imati najveće naučno zvanje i mora biti aktivno angažovana u aktivnostima istraživanja i publikacija koje se sprovode na univerzitetu.</p> <p>2.3. Jedino javni univerziteti mogu ponuditi studijske programe koji vode do kvalifikacija za preduniverzitetske nastavnike. Ministar ima isključivo pravo odobravanja ili uskraćivanja licenciranja tih programa, zasnovano na akreditiranju od strane AKA.</p> <p>2.3.1. Studije za nastavnika predškolskog vaspitanja i osnovnog obrazovanja traju najmanje četiri (4) godine ili 240 ECTS bodova. Samo kandidati koji su završili gimnaziju i koji su ostvarili prosečnu ocenu 4,0 ili više u srednjoškolsko obrazovanje i koji su osvojili najmanje 60% bodova na maturalnom ispitu se mogu kvalifikovati za upis u ovim</p> |
|--|---|---|

| | | |
|--|---|---|
| <p>programe studimi.</p> <p>2.3.2. Studimet për mësimdhënës lëndorë të nivelit të arsimit të mesëm të ulët dhe mesëm të lartë zgjasin së paku pesë (5) vite ose 300 ECTS kredi, përfshirë studimet Baçelor dhe Master. Vetëm kandidatët që kanë përfunduar nivelin Baçelor në fushën përkatëse me një notë mesatare së paku 8.0 ose më shumë kualifikohen për regjistrim në këto programe Master.</p> <p>2.3.3. Kërkesat minimale të përcaktuara në paragrafët 2.3.1 dhe 2.3.2 të këtij neni mund të rishikohen nga Qeveria me propozim të Ministrit, në konsultim me institucionet përkatëse profesionale, me qëllim që të sigurohet niveli më i lartë i mundshëm i mësimdhënësve parauniversitar në funksion të numrit të aplikantëve për çdo nivel dhe disiplinë.</p> <p>3. Kolegji universitar:</p> <p>3.1. Kolegji universitar është në një nivel me një universitet, mirëpo fokusohet më tepër në një fushë specifike të njohurive, në të cilën mund</p> | <p>2.3.2. Studies for subject teacher for the lower secondary school and upper secondary school last at least five (5) years or 300 ECTS credits, including Bachelor and Master studies. Only candidates that have completed a Bachelor degree in the respective field with an average grade of at least 8.0 can be admitted to these Master programs;</p> <p>2.3.3. Minimal requirements set out in paragraphs 2.3.1 and 2.3.2 of this article may be revised by the Government with the proposal of the Minister, in consultation with the relevant professional institutions, in order to ensure the highest possible level of pre-university teachers in view of the number of applicants for each level and discipline.</p> <p>3. University College:</p> <p>3.1. A University College is similar in level to a University, but it covers a more focused or specialised area of knowledge in which it is able to reach</p> | <p>studijским programima.</p> <p>2.3.2. Studije za predmetnog nastavnika za niže i više srednje škole traju najmanje pet (5) godina ili 300 ECTS bodova, uključujući Bachelor i Master studije. Samo kandidati koji su završili Bachelor stepen iz odgovarajuće oblasti sa prosečnom ocenom najmanje 8,0 mogu biti primljeni na ove Master programe.</p> <p>2.3.3. Minimalne zahteve postavljene u stavovima 2.3.1. i 2.3.2. ovog člana može revidirati od strane Vlade uz predlog ministra, uz konsultaciju sa dotičnim profesionalnim institucijama, kako bi se obezbedio najviši mogući nivo preduniverzitetskih nastavnika u pogledu broja kandidata za svaki nivo i disciplinu.</p> <p>3. Univerzitetski koledž:</p> <p>3.1. Univerzitetski koledž je sličan nivou univerziteta, ali pokriva fokusiraniju i specijalizovaniju oblast znanja, kojom se omogućava postizanje</p> |
|--|---|---|

| | | |
|--|--|--|
| <p>të përmbushë standardet ndërkombëtare të mësimdhënies dhe hulumtimit.</p> <p>3.2. Statusi “Kolegj universitar” mund t’i jepet vetëm institucionit të arsimit të lartë që ofron programe studimi të akredituara në nivel të doktoratës në së paku dy (2) disiplina që i takojnë një fushe të njëjtë apo fushave të ndërlidhura të njohurive. Kolegji universitar duhet të ketë së paku tridhjetë (30) anëtarë të personelit akademik me orar të plotë pune dhe së paku gjysma e tyre duhet të kenë thirrjen më të lartë shkencore dhe duhet të jenë të mënyrë aktive të angazhuar në aktivitete hulumtuese dhe botuese që realizohen në Kolegj universitar.</p> <p>4. Kolegj i Arsimit të lartë:</p> <p>4.1. Një "Kolegj i Arsimit të lartë" është institucioni i arsimit të lartë që ofron programe studimi deri në nivel Master, qoftë shkencore (akademike) ose profesionale (të aplikuara). Një Kolegj i Arsimit të lartë nuk mund të ofrojë programe shkencore/akademike në nivel të doktoratës.</p> <p>4.2. Kolegji i arsimit të lartë duhet të ketë së paku gjashtë (6) anëtar të stafit akademik me orar të plotë në secilin</p> | <p>international standards in teaching and research.</p> <p>3.2. The status of "University College" may be granted only to an institution of higher education that offers accredited study programmes at doctorate level in a range of at least two (2) disciplines belonging to the same or related broad knowledge area. A University College must have at least thirty (30) teaching staff members working full time and at least half of them must have highest scientific title and must be actively engaged in research and publication activities carried out at the University College.</p> <p>4. Higher Education College:</p> <p>4.1. A "Higher Education College" is an institution of higher education that offers programs of study up to the Master level, whether scientific (academic) or professional (applied). A Higher Education College cannot offer scientific (academic) doctoral programmes.</p> <p>4.2. A Higher Education College must have for each study program at least six (6) teaching staff members working</p> | <p>međunarodnih standarda na predavanju i istraživanju.</p> <p>3.2. Status „Univerzitetskog koledža“ može se odobriti instituciji visok obrazovanja koja nudi akreditovane studijske programe na doktorskom nivou u rasponu od najmanje dve (2) discipline koje pripadaju istoj ili povezanoj široj oblasti znanja. Univerzitetski koledž mora imati najmanje trideset (30) članova nastavnog osoblja koje radi puno radno vreme i najmanje polovina njih mora imati najviše naučno zvanje i mora biti aktivno angažovana u aktivnostima istraživanja i publikacija koje se sprovode na Univerzitetskom koledžu.</p> <p>4. Koledž visokog obrazovanja:</p> <p>4.1. „Koledž visokog obrazovanja“ je institucija visokog obrazovanja koja nudi programe studiranja do Master nivoa, bilo da je naučni (akademski) ili profesionalni (primenjeni). Koledž visokog obrazovanja ne može da ponudi naučne (akademske) doktorske programe.</p> <p>4.2. Koledž visokog obrazovanja mora imati za svaki studijski program najmanje šest (6) članova nastavnog</p> |
|--|--|--|

| | | |
|---|---|--|
| <p>program studimi, ku së paku tre (3) prej tyre mbajnë thirrjen më të lartë shkencore (për programet akademike) dhe/ose thirrjen më të lartë profesionale (për programet e orientuara në profesion).</p> <p>4.3. Kolegjet e Arsimit të Lartë që ofrojnë së paku pesë (5) programe aplikative në nivelin 6 dhe/apo 7 të KKK mund të përdorin emërtimin e njohur ndërkombëtar të “Fachhochschule”, “Politeknik” apo “Universitet i Shkencave të Aplikuara”.</p> | <p>full-time with at least three (3) of them holding the highest scientific title (for academic programmes) and/or the highest professional title (for professionally-oriented programmes).</p> <p>4.3. Higher Education Colleges offering at least five (5) accredited applied programmes at level 6 and/or 7 of the NQF may use the internationally recognized name of “Fachhochschule”, “Polytechnic” or “University of Applied Sciences”.</p> | <p>osoblja koji rade puno radno vreme sa najmanje tri (3) od njih koji imaju najviše naučno zvanje (za akademske programe) i/ili najviše stručno zvanje (za profesionalno orijentisane programe).</p> <p>4.3. Koledži visokog obrazovanja koji nude najmanje pet (5) akreditovanih primenjenih programa na 6. i/ili 7. nivou NOK mogu koristiti međunarodno priznat naziv „Fachhochschule“, „Politehnički“ ili „Univerzitet primenjenih nauka“.</p> |
| <p>5. Kolegji Profesional dhe Shkolla e lartë Profesionale:</p> <p>5.1. Kolegji profesional është institucion i arsimit të lartë me orientim profesional, që përgatit profesionistë me aftësi praktike në nivelet 5 dhe/ose 6 të KKK. Kolegji profesional dhe Shkolla e lartë profesionale nuk mund të ofrojnë programe studimi në nivel Master ose Doktoratë.</p> <p>5.2. Kolegji profesional dhe Shkolla e Lartë Profesionale mund të themelohen në kuadër të një Universiteti, Kolegji Universitar ose Kolegji të Arsimit të</p> | <p>5. Professional College and Higher Vocational School:</p> <p>5.1. A Professional College or Higher Vocational School is a higher education institution with professional orientation, which prepares professionals with practical skills at levels 5 and/or 6 of the NQF. A Professional College or Higher Vocational School cannot provide study programs at the master or doctoral level.</p> <p>5.2. A Professional College or Higher Vocational School may be established at a university, university college or higher education college; in these cases,</p> | <p>5. Profesionalni koledž ili viša stručna škola:</p> <p>5.1. Profesionalni koledž ili viša stručna škola je institucija visokog obrazovanja sa profesionalnom orijentacijom, koja priprema profesionalce praktičnim veštinama na 5. i/ili 6. nivou NOK. Profesionalni koledž ili viša stručna škola ne može da obezbedi studijske programe na master ili doktorskom nivou.</p> <p>5.2. Profesionalni koledž ili viša stručna škola može da bude uspostavljena na univerzitetu, univerzitetskom koledžu ili koledžu</p> |

| | | |
|---|--|---|
| <p>Lartë; në këto raste ai konsiderohet pjesë e institucionit kryesor; në të gjitha rastet e tjera Kolegji Profesional ose Shkolla e Lartë Profesionale konsiderohet institucion i veçantë i arsimit të lartë.</p> <p>5.3. Statusi “Kolegj Profesional” ose “Shkollë e Lartë Profesionale”, mund t’i jepet institucionit të arsimit të lartë që ofron së paku një (1) program të akredituar të studimit profesional (të aplikuar) në arsimin fillestar dhe/ose të vazhdueshëm të nivelit 5 dhe/ose 6 të KKK. Kolegji Profesional ose Shkolla e Lartë Profesionale duhet të ketë së paku tre (3) mësimdhënës me kualifikim akademik dhe/ose profesional me orar të plotë pune për secilin program studimi.</p> <p>6. Emërtimi i saktë i përdorur nga institucionet e arsimit të lartë duhet të jetë në përputhje të plotë me emërtimin që është dhënë në licencë nga Ministri, në përputhje me këtë Ligj. Përdorimi i emërtimeve “Universitet”, “Kolegj Universitar”, “Kolegj i Arsimit të Lartë”, “Kolegj Profesional” dhe “Shkollë e Lartë Profesionale” dhe termet ndërkombëtare të “Fachhochschule”, “Politeknik” dhe “Universitet i Shkencave të Aplikuara”, është i autorizuar vetëm në përputhje me</p> | <p>it is considered as part of the main institution; in all other cases, the Professional College or Higher Vocational School is considered a separate institution of higher education.</p> <p>5.3. The status of “Professional College” or “Higher Vocational School” may be granted to a higher education institution that provides at least one (1) accredited professional or vocational study program in initial and/or continuing education at level 5 and/or 6 of NQF. A Professional College or Higher Vocational School should have at least three (3) academically and/or professionally qualified full time teacher for each study program.</p> <p>6. The exact name used by the higher education institutions must be in full compliance with the name that is provided in the licence by the Minister, in accordance with this Law. The use of the names “University”, “University College”, “Higher Education College”, “Professional College” and “Higher Vocational School” and the international terms of “Fachhochschule”, “Polytechnic” and “University of Applied Sciences”, is only authorised in accordance with the</p> | <p>visokog obrazovanja; u ovim slučajevima, smatra se kao deo glavne ustanove; u svim drugim slučajevima, profesionalni koledž ili viša stručna škola se smatra posebnom institucijom visokog obrazovanja.</p> <p>5.3. Status „profesionalni koledž“ ili „viša stručna škola“ može se odobriti instituciji visokog obrazovanja koja pruža najmanje jedan (1) akreditovani profesionalni ili stručni studijski program na početnom i/ili kontinuiranom obrazovanju na 5. i/ili 6. nivou NOK. Profesionalni koledž ili viša stručna škola treba da ima najmanje tri (3) kvalifikovana i/ili profesionalna predavača za svaki studijski program.</p> <p>6. Tačan naziv koji je korišćen od strane institucije visokog obrazovanja mora biti u potpunom skladu sa nazivom koji je naveden u licenci od strane ministra, u skladu sa ovim Zakonom. Upotreba imena „Univerzitet“, „Koledž“, „Koledž visokog obrazovanja“, „Profesionalni koledž“ i „Viša stručna škola“ i međunarodnih izraza „Fachhochschule“, „Politehnički“ i „Univerzitet primenjenih nauka“, je moguća samo u skladu sa licencom od ministra. Neovlašćeno korišćenje imena u</p> |
|---|--|---|

| | | |
|---|--|---|
| <p>licencën nga Ministri. Përdorimi i paautorizuar i një emërtimi, në çdo formë, veçmas ose në kombinim me përshkrime të tjera, në një gjuhë kombëtare ose të huaj, në faqen e internetit, në dokumentet e shtypura apo në komunikim apo reklamat në media, është rreptësisht i ndaluar dhe mund të dënohet me tërheqje të licencës dhe me ndjekje penale.</p> <p style="text-align: center;">Neni 9 Sigurimi i brendshëm i cilësisë</p> <p>Të gjitha institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për krijim dhe mirëmbajtjen e një sistemi formal për sigurimin e brendshëm të cilësisë që përfshinë të gjitha programet studimit dhe aktivitetet e tjera të tyre. Duhet të përshijë vlerësimin e programeve të studimit dhe kurseve nga studentët. Struktura dhe funksionimi i sigurimit të brendshëm të cilësisë përcaktohet në statutin e institucionit të arsimit të lartë dhe është pjesë e rëndësishme e rishikimit të akreditimit të institucionit dhe programit.</p> | <p>licence from the Minister. Unauthorised use of a name in any form, alone or in combination with other descriptors, in a national or foreign language, on the website, in print documents or in media communication or advertising, is strictly prohibited and may be punished with withdrawal of licence and prosecution.</p> <p style="text-align: center;">Article 9 Internal quality assurance</p> <p>All higher education institutions are responsible for setting up and maintaining a formal internal quality assurance system encompassing all their study programs and other activities. It must include evaluations of study programmes and courses by students. Structure and functioning of internal quality assurance are defined in the statute of the higher education institution and are an important part of the review for institutional and program accreditation.</p> | <p>bilo kom obliku, samostalno ili u kombinaciji sa drugim opisima, na jednom domaćem ili stranom jeziku, na sajtu, u štampanim dokumentima ili u medijskim komunikacijama i oglašavanjima, je strogo zabranjeno i može se kazniti oduzimanjem licence i podnošenjem tužbe.</p> <p style="text-align: center;">Član 9 Unutrašnje osiguranje kvaliteta</p> <p>Sve institucije visokog obrazovanja su odgovorne za uspostavljanje i održavanje formalnog sistema unutrašnjeg osiguranja kvaliteta obuhvatajući sve svoje studijske programe i druge aktivnosti. Mora da sadrži evaluaciju studijskih programa i kurseva od strane studenata. Struktura i funkcionisanje unutrašnjeg osiguranja kvaliteta su definisani u statutu institucije visokog obrazovanja i predstavljaju važan deo pregleda za institucionalnu i akreditaciju programa.</p> |
|---|--|---|

| <p style="text-align: center;">Neni 10 Arsimi i vazhdueshëm dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës</p> | <p style="text-align: center;">Article 10 Continuing Education and Lifelong Learning</p> | <p style="text-align: center;">Član 10 Kontinuirano obrazovanje i učenje tokom celog života</p> |
|---|--|--|
| <p>1. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë mund të ofrojnë arsimim të vazhdueshëm si një formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës për të njëjtat nivele për të cilat ofrojnë programe të akredituara për studentë të arsimit fillestar.</p> <p>2. Arsimimi i vazhdueshëm mund të shërbej për të plotësuar, thelluar dhe konsoliduar njohuritë dhe kompetencat dhe mund të ofrohet në formate dhe mënyra të ndryshme, përfshirë programe të rëndomta të studimit, kurse të shkurtra, kurse verore, cikle ri-kualifikimi, arsimimin digjital apo nga largësia, etj.</p> <p>3. Arsimimi i vazhdueshëm mund të shpie në një kualifikim të plotë, për studentët e rregullt apo me korrespondencë që përfundojnë të gjitha njësitë e kurseve apo lirim nga ky obligim në bazë të Njohjes së Mësimi Paraprak (NjMP).</p> | <p>1. All higher education institutions can provide continuing education as a form of lifelong learning at the same levels for which they offer accredited programmes for initial education students.</p> <p>2. Continuing education may serve to complement, deepen and consolidate knowledge and competencies and can be provided in various formats and modes including ordinary study programs, short courses, summer courses, re-qualification cycles, digital or distance education etc.</p> <p>3. Continuous education may lead to a full qualification for those full-time or part-time students who complete all course units or are exempted from this obligation under the Recognition of Prior Learning (RPL).</p> | <p>1. Sve institucije visokog obrazovanja mogu da obezbede kontinuirano obrazovanje kao vid učenja tokom celog života na istim nivoima na kojima oni nude akreditovane programe za obrazovne studente početnike.</p> <p>2. Kontinuirano obrazovanje može poslužiti kao dopuna, produblјivanje i konsolidovanje znanja i kompetencija i može se obezbediti u različitim formatima i načinima, uključujući obične programske studije, kratke kurseve, letnje kurseve, cikluse prekvalifikacije, digitalno ili obrazovanje na daljinu itd.</p> <p>3. Kontinuirano obrazovanje može dovesti do potpune kvalifikacije, za studente koji završavaju sve jedinice kurseva ili oslobađanje od ove obaveze na osnovu Priznavanja prethodnog učenja (PPU).</p> |

| <p style="text-align: center;">Neni 11 Statusi ligjor i institucioneve të arsimit të lartë</p> | <p style="text-align: center;">Article 11 Legal status of higher education institutions</p> | <p style="text-align: center;">Član 11 Pravni status institucija visokog obrazovanja</p> |
|--|--|---|
| <p>1. Institucionet e arsimit të lartë publike dhe jopublike duhet të kenë statusin e personit juridik dhe mund të padisin dhe të paditën.</p> <p>2. Institucionet publike të arsimit të lartë, qoftë universitetet publik apo ndonjë lloj tjetër i institucioneve, mund të themelohen vetëm me vendim të Qeverisë i cili ratifikohet nga Kuvendi, apo me ligj të veçantë.</p> <p>3. Institucioni jopublik i arsimit të lartë mund të themelohet nga individë, biznese, fondacione apo shoqata që janë person juridik dhe kanë një zyrë të regjistruar në Kosovë.</p> <p>4. Institucionet e arsimit të lartë bazuar në partneritetin publiko-privat konsiderohen si institucione publike nëse janë themeluar me ligj apo me vendim të Qeverisë dhe të ratifikuara në Kuvend. Në të gjitha rastet tjera ato konsiderohen si institucione jopublike të arsimit të lartë.</p> <p>5. Institucionet e huaja të arsimit të lartë</p> | <p>1. Higher educational institutions, both public and non-public shall have the status of legal person and may sue and be sued.</p> <p>2. Public higher education institutions, whether a public university or any other type of institution, can only be established by a decision of the Government ratified by the Assembly, or by a special law.</p> <p>3. A non-public institution of higher education can be established by a person, company, foundation, trust or association which is a legal person and holds a registered office in Kosova.</p> <p>4. Higher Education institutions based on a public-private partnership are considered as public institutions if they are established by a law or by a decision of the Government and ratified by the Assembly. In all other cases, they are considered as non-public higher education institutions.</p> <p>5. Foreign higher education institutions</p> | <p>1. Javne i nejavne institucije visokog obrazovanja treba da imaju status pravnog lica i mogu tužiti i biti tužene.</p> <p>2. Javne institucije visokog obrazovanja, bez obzira da li su javni univerzitet ili bilo koja druga vrsta institucije, može se utvrditi samo na osnovu odluke Vlade koja je ratifikovana u Skupštini, ili posebnim zakonom.</p> <p>3. Nejavnu instituciju visokog obrazovanja može osnovati osoba, kompanija, fondacija, povereničko društvo ili udruženje sa pravnim subjektivitetom i kancelarija registrovana na Kosovu.</p> <p>4. Institucije visokog obrazovanja zasnovane na javno-privatnom partnerstvu se smatraju javnim institucijama ukoliko su osnovane zakonom ili odlukom Vlade i ukoliko su ratifikovane u Skupštini. U svim drugim slučajevima, one se smatraju nejavnim institucijama visokog obrazovanja.</p> <p>5. Strane institucije visokog obrazovanja</p> |

| | | |
|--|--|---|
| <p>që funksionojnë në Kosovë i nënshtrohen rregullave për institucionet jopublike të arsimit të lartë; nëse dëshirojnë të japin diploma në Kosovë, ato duhet t'i nënshtrohen procedurave të njëjta të akreditimit dhe licencimit njësoj si institucionet e tjera jopublike të arsimit të lartë; nëse ofrojnë arsim i cili shpie në marrjen e një grade të huaj, duhet t'i demonstrojnë AKA-së që programi dhe/ose institucioni është i akredituar në përputhje me rregullat në vendin e tij nga një organ akreditues i njohur.</p> <p>6. Të gjithë institucionet e licencuara të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, pavarësisht statusit të tyre, duhet të kenë:</p> <p>6.1. Lirinë akademike të stafit dhe studentëve, e cila duhet të garantohet në statutet e institucioneve të arsimit të lartë;</p> <p>6.2. Lirinë e asocimit dhe bashkëpunimit me institucionet e tjera, si në nivel institucional ashtu edhe në nivel të grupeve të tyre përbërëse siç janë studentët, mësimdhënësit dhe kategoritë e tjera;</p> <p>6.3. Dokumentet e notave dhe diplomave do të jenë në përputhje me përmbajtjen dhe formatin e aprovuar nga Ministria,</p> | <p>operating in Kosova are submitted to the regulation for non-public higher education institutions. If they want to award a Kosova degree, they must undergo the same accreditation and licensing procedures as other non-public higher education institutions. If they deliver education leading to a foreign degree, they have to demonstrate to KAA that programme and/or institution is accredited in accordance with the regulations of his/her country by a recognized accreditation body.</p> <p>6. All licensed higher education institutions in the Republic of Kosova, irrespective of their status, shall have:</p> <p>6.1. Academic freedom of staff and students, which must be guaranteed in the higher education institutions statutes;</p> <p>6.2. The freedom of association and cooperation with other institutions, both at the institutional level and at the level of their main constituting groups such as students, teachers and other categories;</p> <p>6.3. Documents of grades and of diplomas will be in compliance with the adopted content and format by the</p> | <p>koje funkcionišu na Kosovu podležu uredbi za nejavne institucije visokog obrazovanja. Ukoliko žele da daju diplome na Kosovu, one treba da podležu istim procedurama akreditovanja i licenciranja isto kao i ostale nejavne institucije visokog obrazovanja. Ukoliko pružaju obrazovanje koje vodi do dobijanja strane diplome, treba da dokažu AKA-u da je program i/ili institucija akreditovana u skladu sa pravilima u njegovom mestu od strane priznatog akreditacionog organa.</p> <p>6. Sve licencirane institucije visokog obrazovanja na Kosovu, bez obzira na njihov status, treba da imaju:</p> <p>6.1. Akademsku slobodu osoblja i studenata, koja se treba garantovati u statutima institucija visokog obrazovanja;</p> <p>6.2. Slobodu udruživanja i saradnje sa drugim institucijama, kako na institucionalnom nivou tako i nivou njihovih sastavnih grupa kao što su studenti, nastavnici i druge kategorije;</p> <p>6.3. Dokumenti ocena i diploma biće u skladu sa prilagođenim sadržajem i formatom od Ministarstva, što je</p> |
|--|--|---|

| | | |
|--|--|---|
| <p>që specifikohet përmes aktit nën-ligjor;</p> <p>KAPITULLI IV: QEVERISJA E SISTEMIT TË ARSIMIT TË LARTË NË KOSOVË</p> <p>Neni 12 Kompetencat e Ministrit</p> <p>1. Në përputhje me dispozitat e këtij Ligji dhe me dokumentet plotësuese të nxjerra mbi bazën e tij dhe të atyre të nxjerra në bazë të nenit 14 të Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës (21 maj 2008), Qeveria e Republikës së Kosovës përcakton drejtimet kryesore të politikave shtetërore për sistemin e arsimit të lartë në tërësi dhe për institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.</p> <p>2. Kompetencat e ministrit përgjegjës për arsimin e lartë përfshijnë fushat e mëposhtme:</p> <p>2.1. Propozimin e akteve ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me çështje të arsimit të lartë;</p> <p>2.2. Përcjelljen dhe mbikëqyrjen e</p> | <p>Ministry, specified through sub-legal act;</p> <p>CHAPTER IV: GOVERNANCE OF THE HIGHER EDUCATION SYSTEM IN KOSOVA</p> <p>Article 12 Competences of the Minister</p> <p>1. In accordance with the provisions of this Law and additional documents issued under it and those issued according to article 14 of Law no. 03-L-068 on Education in Municipalities of the Republic of Kosovo (21 may 2008), the Government of the Republic of Kosovo determines the main orientations of state policies for the higher education system as a whole and for higher education institutions in the Republic of Kosovo.</p> <p>2. The competences of the Minister responsible for higher education include the following areas:</p> <p>2.1. Proposal of legal and sub-legal acts dealing with higher education matters;</p> <p>2.2. Overview and supervision of the</p> | <p>precizirano podzakonskim aktom;</p> <p>POGLAVLJE IV: UPRAVLJANJE SISTEMOM VISOKOG OBRAZOVANJA NA KOSOVU</p> <p>Član 12 Kompetencije ministra</p> <p>1. U skladu sa odredbama ovog Zakona i dodatnim dokumentima izdatim na osnovu istog i onih izdatih na osnovu člana 14. Zakona br. 03-L-068 o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo (21. maj 2008. godine), Vlada Republike Kosovo određuje glavne orijentacije državnih politika za sistem visokog obrazovanja kao celina kao i za institucije visokog obrazovanja u Republici Kosovo.</p> <p>2. Dužnosti Ministra koji je odgovoran za visoko obrazovanje obuhvata sledeće oblasti:</p> <p>2.1. Predlaže zakonske i podzakonske akte koje se odnose na pitanja visokog obrazovanja ;</p> <p>2.2. Pregleda i nadgleda sprovođenje</p> |
|--|--|---|

| | | |
|--|---|--|
| <p>realizimit të politikave dhe ligjeve në arsimin e lartë;</p> <p>2.3. Propozimin e politikave në Qeveri në fushën e pagave dhe kompensimeve në institucionet publike të arsimit të lartë;</p> <p>2.4. Planifikimin dhe zhvillimin e sistemit të arsimit të lartë në të gjitha nivelet dhe në të gjitha aspektet, publike dhe jopublike, përfshirë arsimin profesional/ parauniversitar, arsimin e vazhdueshëm dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, në konsultim me institucionet e arsimit të lartë dhe palët e interesit;</p> <p>2.5. Në bazë të konsultimeve me AKA-në, propozimin për miratimin statuteve të institucioneve publike të arsimit të lartë para ratifikimit nga Kuvendi (për institucionet publike) apo nga Qeveria (për institucionet jopublike) të arsimit të lartë;</p> <p>2.6. Propozimin për ndarjen e fondeve për institucionet e arsimit të lartë në kuadër të dispozitave të përgjithshme të ligjit për financimin e shërbimeve publike në Kosovë;</p> <p>2.7. Nënshkrimin e marrëveshjeve me</p> | <p>implementation of policies and legislation in higher education;</p> <p>2.3. Proposal of policies concerning salaries and remuneration at public higher education institutions;</p> <p>2.4. Planning and development of the whole system of higher education at all levels and in all aspects, public and non-public, including post-secondary vocational/professional education, continuing education and lifelong learning, in consultation with higher education institutions and stakeholders;</p> <p>2.5. On the basis of a consultation with KAA, proposal for approval of the statutes of institutions of higher education before their ratification by the Assembly (for public institutions), or by Government (for non-public higher education institutions);</p> <p>2.6. Proposal for the allocation of funds to higher education institutions within the general provisions of the Law on the financing of public services in Kosovo;</p> <p>2.7. Signing of agreements with public</p> | <p>politika i zakonodavstva u visokom obrazovanju ;</p> <p>2.3. Predlaže poltike vezano za plate i naknade u javnim institucijama visokog obrazovanja;</p> <p>2.4. Planiranje i razvijanje celokupnog sistema visokog obrazovanja na svim nivoima i svim segmentima, javnim i nejavnim, uključujući stručno obrazovanje i osposobljavanje nakon srednjeg školovanja, kontinuirano obrazovanje i učenje tokom celog života, u konsultaciji sa institucijama i zainteresovanim stranama iz visokog obrazovanja;</p> <p>2.5. Zasnovano na konsultacije sa AKA, predlog o usvajanju statuta institucija visokog obrazovanja pre ratifikacije od strane Skupštine (za javne institucije) ili od strane Vlade (za nejavne institucija visokog obrazovanja);</p> <p>2.6. Predlog za raspodelu sredstava za institucije visokog obrazovanja u okviru opštih odredaba Zakona o finansiranju javnih usluga na Kosovu;</p> <p>2.7. Potpisivanje ugovora sa javnim</p> |
|--|---|--|

| | | |
|---|--|---|
| <p>institucionet publike të arsimit të lartë ku përcaktohen zhvillimet strategjike që duhet ndërmerren nga institucioni dhe kushtet për mbështetje financiare nga Ministria;</p> <p>2.8. Përcaktimin, me akt nënligjor, të formatit dhe përmbajtjes së gradave akademike, diplomave dhe të shtojcave të diplomës, të lëshuara nga institucionet e akredituara dhe licencuara të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës;</p> <p>2.9. Themelimin e një skeme ose skemave për mbështetjen financiare të studentëve dhe rregullimin e administrimit të një skeme apo skemave të tilla;</p> <p>2.10. Promovimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe mobilitetit të studentëve dhe kuadrit akademik brenda zonës evropiane dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë si dhe inkurajimin për përdorimin e gjuhës angleze për mësim krahas gjuhëve zyrtare të Kosovës;</p> <p>2.11. Vendorsjen e rregullave lidhur me njohjen akademike dhe profesionale, në përputhje me standardet evropiane, përmes ENIC/NARIC Kosova ose</p> | <p>higher education institutions which set out the strategic developments to be undertaken by the institution and the conditions for financial support from the Ministry;</p> <p>2.8. Determination, by a sub-legal act, of the format and content of academic degrees, diplomas and diploma supplements, issued by accredited and licensed institutions of higher education in the Republic of Kosovo;</p> <p>2.9. Establishment of a scheme or schemes for student financial support and regulation of such scheme or schemes;</p> <p>2.10. Promotion of international cooperation and of student and staff mobility within the European and international area of higher education and encouragement on the use of the English language alongside Kosova's official languages;</p> <p>2.11. Establishment of rules regarding academic and professional recognition, in accordance with European standards, through ENIC/NARIC Kosova or</p> | <p>institucijama visokog obrazovanja koje definišu strateški razvoj koje će preduzeti institucije i uslove za finansijsku podršku od ministarstvo;</p> <p>2.8. Određivanje, ovim podzakonskim aktom, formata i sadržaja akademskih zvanja, diploma i diplomskih dodataka, izdatih od strane akreditovanih i licenciranih institucija visokog obrazovanja u Republici Kosovo;</p> <p>2.9. Osnivanje jedne šeme ili šema za finansijsku podršku studentima i regulisanje te šeme ili sličnih šema;</p> <p>2.10. Promociju međunarodne saradnje i mobilnosti studenata i osoblja unutar Evropske i Međunarodne oblasti visokog obrazovanja i podsticanje upotrebe engleskog jezika pored službenih jezika Kosova;</p> <p>2.11. Uspostavljanje pravila u vezi akademskog i profesionalnog priznavanja, u skladu sa evropskim standardima, kroz ENIC/NARIC</p> |
|---|--|---|

| | | |
|--|---|--|
| <p>përmes Agjencisë së Kosovës për Akreditim, dhe informim të publikut për statusin e kualifikimeve të huaja në Kosovë;</p> <p>2.12. Përcaktimin, në konsultim me agjencitë e tjera shtetërore dhe Qeverinë, të nivelit të diplomës dhe kërkesave shitesë për punësim në disa profesione të caktuara, në përputhje me ligjet e tjera që rregullojnë profesionet si dhe me konventat kombëtare dhe ndërkombëtare;</p> <p>2.13. Promovimi i transparencës së informacionit në dispozicion të studentëve dhe shoqërisë dhe i mundësive të barabarta për pranim në arsimin e lartë, i zhvillimit dhe trajnimit të stafit, mundësive për të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe i të gjitha aspekteve të tjera të arsimit të lartë;</p> <p>2.14. Krijimin dhe funksionimin e Këshillit Shtetëror për Arsimin e Lartë (KShAL), i cili është organ këshillimor i Kryeministrit dhe Ministrit për politikën e arsimit të lartë. Ministri propozon anëtarët e KShAL të cilët me pas emërohen nga Kryeministri. Mandatit anëtarëve të KShAL-it si dhe organizimi, funksionimi dhe aktivitetet e KShAL-it, përcaktohen me akt</p> | <p>through the Kosova Accreditation Agency, and information of the public on the status of foreign qualifications in Kosova;</p> <p>2.12. Determination, in consultation with other state agencies and Government, of the degree of diploma and other requirements for employment in certain professions, in compliance with other laws regulating professions and with national and international conventions;</p> <p>2.13. Promotion of transparency of information made available to students and society and of equality of opportunities in admission to higher education, in staff development and training, in opportunities for lifelong learning and in all other aspects of higher education;</p> <p>2.14. Establishment and functioning of the State Council of Higher Education (SCHE), which is an advisory body to the Prime Minister and the Minister on higher education policies. The Minister proposes the SCHE members, who are then appointed by the Prime Minister. The terms of office of SCHE members, as well as the organization, functioning and activities of SCHE, are determined</p> | <p>Kosovo ili kroz Agenciju Kosova za akreditaciju, i informisanje javnosti o statusu stranih kvalifikacija na Kosovu;</p> <p>2.12. Određivanje dodatnih zahteva, u konsultaciji sa drugim državnim agencijama i Vladom, o stepenima diploma koje se koriste za zapošljavanje u nekoliko određenih profesija, u skladu sa drugim zakonima koji regulišu profesije kao i nacionalne i međunarodne konvencije;</p> <p>2.13. Promovisanje transparentnosti informacija na raspolaganju studentima i društvu i jednakosti mogućnosti za prijem u visoko obrazovanje, razvoja osoblja i obuke, mogućnosti za učenje celog života i u svim drugim aspektima visokog obrazovanja;</p> <p>2.14. Osnivanje i funkcionisanje Nacionalnog saveta za visoko obrazovanje (NSVO) koji je savetodavno telo Premijera i Ministra za politike visokog obrazovanja. Ministar predlaže članove NSVO koji se potom imenuju od strane Premijera. Mandat članova NSVO, kao i organizaciju, funkcionisanje i aktivnosti NSVO, se utvrđuju</p> |
|--|---|--|

| | | |
|--|--|---|
| <p>nënligjor që propozohet nga ministri dhe miratohet në Qeveria;</p> <p>2.15. Promovimin e bashkëpunimit midis institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, si dhe industrinë, tregtinë dhe inkurajimin e ndërmarrësisë;</p> <p>2.16. Licencimin e institucioneve të arsimit të lartë, publike dhe jopublike, në bazë të akreditimit të tyre, sipas aktit nënligjor të propozuar nga Ministri dhe të miratuar nga Qeveria, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me ligj të veçantë;</p> <p>2.17. Kontrollimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë me aktet nënligjore dhe statutet në fuqi;</p> <p>2.18. Rregullimin e të gjitha çështjeve të tjera lidhur me arsimin e lartë, të cilat nuk janë të rregulluara veçmas në bazë të këtij Ligji.</p> <p>3. Në ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të saj/tij në bazë të këtij Ligji, Ministri respekton dhe promovon të drejtat e komuniteteve të ndryshme dhe anëtarëve të tyre, si dhe të personave me nevoja të veçanta siç janë përcaktuar në</p> | <p>with a sublegal act proposed by the Minister and approved by the Government;</p> <p>2.15. Promotion of cooperation between higher education institutions in Kosovo, as well as industry, trade and encouraging of entrepreneurship;</p> <p>2.16. Licensing of higher education institutions, both public and non-public, on the basis of their accreditation, in accordance with the sublegal act proposed by the Minister and approved by the Government, unless defined otherwise by a special law;</p> <p>2.17. Control of compliance of higher education institutions with applicable bylaws and statutes;</p> <p>2.18. Regulation of other issues regarding higher education, which are not regulated separately based on this Law.</p> <p>3. In exercising its responsibilities and duties under this Law, the Minister respects and promotes the rights of different communities and their members, as well as persons with disabilities, as defined in the applicable laws on the</p> | <p>podzakonskim aktom prema predlogu ministra i usvajanje od strane Vlade;</p> <p>2.15. Promovisanje saradnje između institucija visokog obrazovanja na Kosovu, kao i industrije, trgovine i podsticanje preduzetništva;</p> <p>2.16. Licenciranje institucija, javnih i nejavnih, visokog obrazovanja, na osnovu njihove akreditacije, prema podzakonskom aktu predloženog od strane Vlade, osim ukoliko je određeno drugačije posebnim zakonom;</p> <p>2.17. Kontrola usklađenosti institucija visokog obrazovanja sa važećim podzakonskim aktima i statutima;</p> <p>2.18. Regulisanje svih drugih pitanja u vezi visokog obrazovanja, koja nisu posebno regulisana na osnovu ovog Zakona.</p> <p>3. U vršenju svojih odgovornosti i obaveza na osnovu ovog Zakona, ministar poštuje i promovise prava različitih zajednica i njihovih članova, kao i lica sa ograničenim sposobnostima, kao što je određeno važećim zakonodavstvom za zaštitu i</p> |
|--|--|---|

| | | |
|--|--|--|
| <p>legjislacionin në fuqi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, si dhe të personave me nevoja të veçanta në Kosovë.</p> | <p>protection and promotion of the rights of communities and their members, as well as persons with disabilities in Kosovo.</p> | <p>promovisanje prava zajednica i njihovih pripadnika, kao i lica sa ograničenim sposobnostima na Kosovu.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 13 Agjencia e Kosovës për Akreditim</p> | <p style="text-align: center;">Article 13 Kosova Accreditation Agency</p> | <p style="text-align: center;">Član 13 Agencija Kosova za akreditaciju</p> |
| <p>1. Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) është agjenci e pavarur e themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës për t'u marrë me vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë. AKA-ja ka pavarësi të plotë për realizimin e proceseve profesionale dhe transparente të vlerësimit, akreditimit dhe monitorimit apo mjeteve të tjera që konsiderohen të përshtatshme dhe që i plotësojnë praktikat më të mira ndërkombëtare.</p> <p>2. AKA gëzon pavarësi në hartimin dhe miratimin e procedurave, kritereve dhe formateve të saj të vlerësimit, rregullave për përzgjedhjen e ekspertëve ndërkombëtarë dhe komisioneve të posaçme të vlerësimit, si dhe në vendimmarrjen dhe publikimin e tyre lidhur me vlerësimin e cilësisë. AKA përcakton statutin e saj bazuar në këtë Ligj, që i nënshtrohet aprovimit nga Qeveria.</p> | <p>1. Kosova Accreditation Agency (KAA) is an independent agency set up by the Government of Republic of Kosovo to deal with the evaluation and assurance of quality in higher education in Kosovo. KAA enjoys full independence to run, professional and transparent processes of evaluation, accreditation and monitoring or other means that are considered appropriate and meet the best international practices.</p> <p>2. KAA shall be independent in the drafting and adoption of its procedures, criteria and assessment formats, regulations on selection of international experts and special evaluation committees, as well as their decision-making and publication regarding the evaluation of quality. KAA defines its own statutes on the basis of this Law, subject to their approval by the Government.</p> | <p>1. Agencija Kosova za akreditaciju (AKA) je nezavisna agencija osnivana od strane Vlade Republike Kosova da se bavi evaluacijom i promovisanjem kvaliteta u visokom obrazovanju na Kosovu- AKA uživa potpunu nezavisnost za vođenje profesionalne i transparentne procese evaluacije, akreditacije i praćenja ili ostala sredstava koja se smatraju odgovarajućim i ispunjavaju najbolje međunarodne prakse.</p> <p>2. AKA uživa nezavisnost u izradi i usvajanju svojih procedura, kriterijuma i formata procenjivanja, pravila za odabiranje međunarodnih stručnjaka i posebnih komisija za procenjivanje, kao i u odlučivanju i objavljivanju istih u vezi sa procenjivanjem kvaliteta. AKA definiše svoje statute na osnovu ovog Zakona, koji su predmet usvajanja od strane Vlade.</p> |

| | | |
|--|--|---|
| <p>3. AKA siguron që standardet dhe procedurat e saj për cilësinë e arsimit të lartë në Kosovë janë në përputhje me standardet evropiane dhe Udhëzuesit për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë që janë të përbashkëta për të gjitha agjencitë e sigurimit të cilësisë që janë anëtare të plota në ENQA dhe EQAR.</p> <p>4. Në përputhje me këtë Ligj dhe me instrumentet e tjera ndihmëse të nxjerra në bazë të tij, AKA është gjithashtu përgjegjëse për:</p> <p>4.1. Ofrimin e këshillave për Ministrin lidhur me kërkesat e institucioneve për licencim;</p> <p>4.2. Monitorimin e institucioneve të arsimit të lartë për zbatimin e kushteve të akreditimit dhe këshillimin me Ministrin lidhur me dhënien, ndryshimin, kufizimin ose anulimin e licencave;</p> <p>4.3. Kryerjen e kontroleve periodike të cilësisë dhe auditimit në institucionet e arsimit të lartë me qëllim të nxjerrjes së vendimit për akreditimin apo riakreditimin e tyre, duke përfshirë të drejtën e tyre për dhënien e titujve dhe diplomave, si dhe në revokimin e akreditimit;</p> | <p>3. KAA ensures that its standards and procedures for higher education quality in Kosovo are in line with the European Standards and Guidelines for quality assurance in higher education that are common to all quality assurance agencies who are full members of ENQA and EQAR.</p> <p>4. In compliance with this Law and other auxiliary instruments issued under it, KAA is also responsible for:</p> <p>4.1. Providing advice to the Minister with regard to institutions requests for licensing;</p> <p>4.2. Monitoring of higher education institutions on the implementation of accreditation conditions and advising the Minister on the granting, amendment, limitation or revocation of licenses;</p> <p>4.3. Conducting periodic quality checks and audits at higher education institutions in order to take decisions on their accreditation or reaccreditation, including with respect to their right to grant titles and diplomas, as well as on the withdrawal of such accreditation;</p> | <p>3. AKA obezbeđuje da su njeni standardi i procedure za kvalitet visokog obrazovanja na Kosovu u skladu sa evropskim standardima i smernicama za osiguranje kvaliteta u visokom obrazovanju koje su zajedničke za sve agencije za osiguranje kvaliteta, koje su punopravne članice ENQA i EQAR.</p> <p>4. U skladu sa ovim Zakonom i drugim pomoćnim instrumentima izdatim na osnovu istog, AKA je takođe odgovorna za:</p> <p>4.1. Pružanje saveta Ministru u vezi zahteva institucija za licenciranje;</p> <p>4.2. Praćenje institucija visokog obrazovanja za sprovođenje uslova akreditacije i savetovanje ministra u vezi davanja, izmene i dopune, ograničenja ili ukidanja licenci;</p> <p>4.3. Sprovođenje periodičnih kontrola kvaliteta i revizija u institucijama visokog obrazovanja sa ciljem izdavanja odluke za njihovu akreditaciju i ponovnu akreditaciju, uključujući i njihovo pravo za pružanje zvanja i diploma, kao i za oduzimanje takve akreditacije;</p> |
|--|--|---|

| | | |
|--|--|--|
| <p>4.4. Komisionimi në intervale të rregullta prej rreth dy (2) vitesh të një raporti gjithëpërfshirës të pavarur për rishikimin e cilësisë dhe zhvillimin e arsimit të lartë në Kosovë, që do të financohet nga Ministria. Këto raporte duhet të jenë nga një ekip i ekspertëve ndërkombëtarë, që nxjerrin kontribute nga të gjithë palët e interesuar të Kosovës dhe duhet t'i paraqitet Këshillit Shtetëror për Arsimin e Lartë dhe në Kuvend;</p> <p>4.5. Kryerjen e atyre funksioneve të deleguara nga Ministri, lidhur me kualifikimet akademike dhe profesionale dhe në veçanti aftësinë të veproj si organ kompetent për rregullimin e kualifikimeve në arsimin e lartë në përputhje me ligjin për kualifikimet shtetërore dhe në këshillim me Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve;</p> <p>4.6. Ndërmarrjen e aktiviteteve të tjera dhe sipërmarrjeve të përbashkëta me iniciativën e saj e që janë në përputhje me standardet koherente evropiane dhe ndërkombëtare për arsimin e lartë dhe që kanë qëllim sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë dhe standardeve të arsimit të lartë në Kosovë;</p> | <p>4.4. Commissioning at regular intervals of about two (2) years a comprehensive independent report reviewing the quality and development of higher education in Kosova, to be funded by the Ministry. These reports must be by a team of international experts drawing on inputs from all Kosova stakeholders and must be presented to the State Council on Higher Education and to the Assembly;</p> <p>4.5. Performance of any other function delegated to it by the Minister, with regard to academic and professional qualifications and in particular capacity to act as competent body for the regulation of qualifications in higher education in compliance with the law on state qualifications and in consultation with the National Qualifications Authority;</p> <p>4.6. Undertaking at its own initiative other activities and cooperative ventures that are in line with coherent European and international standards on Higher Education and are intended to ensure and improve the quality and standards of higher education in Kosova;</p> | <p>4.4. Izdavanje u redovnim intervalima od oko dve (2) godine sveobuhvatnog nezavisnog izveštaja preispitujući kvalitet i razvoj visokog obrazovanja na Kosovu, koji će finansirati ministarstvo. Ove izveštaje moraju izraditi međunarodni stručnjaci oslanjajući se na inpute svih kosovskih zainteresovanih strana i moraju biti predstavljeni Državnom savetu za visoko obrazovanje i Skupštini;</p> <p>4.5. Sprovođenje funkcija koje je ministar delegirao, u vezi akademskih i profesionalnih kvalifikacija, i posebno u pogledu kapaciteta da deluje kao organ nadležan za regulisanje kvalifikacija u visokom obrazovanju u skladu sa Zakonom o državnim kvalifikacijama, i u konsultacijama sa Nacionalnim organom za kvalifikacije;</p> <p>4.6. Preduzimanje, na sopstvenu inicijativu, drugih aktivnosti i poduhvata zajedničke saradnje koji su u skladu sa koherentnim evropskim i međunarodnim standardima o visokom obrazovanju i imaju za cilj da osiguraju i poboljšaju kvalitet i standarde visokog obrazovanja na Kosovu;</p> |
|--|--|--|

| | | |
|---|---|---|
| <p>5. AKA mbështet institucionet e arsimit të lartë në ngritjen dhe funksionimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p> <p>6. AKA publikon kriteret dhe standardet e saj për akreditim si dhe vendimet e akreditimit, rekomandimet dhe konkludimet nga kontrollt e saja të cilësisë; gjithashtu publikon edhe raportin vjetor.</p> <p>7. Organi qeverisës i AKA-së është Bordi i saj. Bordi është organ vendimmarrës dhe i pavarur në veprimtarinë e tij dhe i cili përbëhet nga jo më pak se shtatë (7) anëtarë dhe jo më shumë se nëntë (9) anëtarë, të propozuar nga Ministri dhe emëruar nga Qeveria, për një mandat të caktuar katër (4 vjeçar) (më të drejtën e riemërimit edhe për një mandat); anëtarët duhet jenë nga radhët e të dy gjinive, të kanë përvojë të gjerë dhe të drejtpërdrejtë me cilësinë në arsimin e lartë brenda dhe/ose jashtë Kosovës); të paktën tre (3) anëtarë duhet jenë ekspert ndërkombëtarë të cilët nuk janë dhe nuk kanë qenë punëtor të ndonjë institucioni të arsimit të lartë në Kosovë; Bordi zgjedh kryetarin e saj nga radhët e anëtarëve të saj.</p> <p>8. Bordi i AKA-së merr vendimin</p> | <p>5. KAA supports higher education institutions on the establishment and functioning of their internal quality assurance system.</p> <p>6. KAA publishes its standards and criteria for accreditation as well as the accreditation decisions, recommendations and conclusions of its quality checks; it also publishes an annual report.</p> <p>7. KAA's governing body is its Board. The Board is independent in its activities and its decision-making. It consists of no less than seven (7) and no more than nine (9) members proposed by the Minister and appointed by the Government for a fixed term of four (4) years (once renewable); members must be of both genders, have extensive direct experience with quality in higher education within and/or outside Kosova; at least three (3) members must be international experts who are not or were not employees of any higher education institution in Kosova; The Board elects its president from among its members.</p> <p>8. KAA's Board takes the final decision</p> | <p>5. AKA podržava institucije visokog obrazovanja na uspostavljanju i funkcionisanju njihovog sistema unutrašnjeg osiguranja kvaliteta.</p> <p>6. AKA objavljuje svoje standarde i kriterijume za akreditaciju kao i odluke, preporuke i zaključke akreditacije svojih provera kvaliteta, a takođe objavljuje i godišnji izveštaj.</p> <p>7. Upravljačko telo AKA je njen Odbor. Odbor je nezavisan u svojim aktivnostima i donošenju odluka. Sastoji se od najmanje pet (5) a najviše devet (9) članova koji su predloženi od strane ministara a imenovani od strane Vlade, za jedan određeni mandat od četiri (4) godine (sa pravom ponovnog imenovanja još jednog mandata); članovi treba da budu oba pola, treba da imaju široko, direktno iskustvo sa kvalitetom u visokom obrazovanju na i/ili van Kosova); najmanje tri (3) člana treba da budu međunarodni stručnjaci, koji nisu i nisu bili radnici neke institucije visokog obrazovanja na Kosovu; Odbor bira svojeg predsednika među svojim članovima.</p> <p>8. Odbor AKA donosi konačnu</p> |
|---|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| <p>përfundimtar për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve që ato ofrojnë.</p> <p>9. Anëtarë të Bordit të AKA-së nuk mund të jenë zyrtarët e lartë publikë që mbajnë poste politike në institucionet e Republikës së Kosovës.</p> <p>10. Me propozimin e Bordit të AKA apo Ministrisë, Qeveria mund të shkarkojë anëtarin e Bordit para përfundimit të mandatit të tij/saj për këto arsye:</p> <p>10.1. Dënim për një vepër penale që ndëshkohet me burgim;</p> <p>10.2. Paaftësi në kryerjen e funksioneve të postit për shkak të paaftësisë fizike apo mendore, të dokumentuar me një raport nga së paku dy (2) mjek, të caktuar sipas legjislacionit në fuqi;</p> <p>10.3. Dështim, refuzim, shpërfillje, paaftësi të vazhdueshme për të përmbushur detyrat e postit, ose për të vepruar në përputhje me parimet e përcaktuara në statutin dhe rregulloret e AKA-së apo në këtë Ligj.</p> | <p>on the accreditation of higher education institutions and their programs.</p> <p>9. KAA Board members cannot be high public officials who currently hold political posts in the institutions of Republic of Kosovo.</p> <p>10. Upon proposal of the KAA Board or the Minister, the Government may dismiss a member of the Board prior to the expiration of his/her mandate for convincing reasons, such as:</p> <p>10.1. Punishment for a criminal offense, which is punishable by imprisonment;</p> <p>10.2. Incapability to performance office functions due to physical or mental disability, documented in a report of at least two (2) doctors assigned according to legislation in force;</p> <p>10.3. Ongoing failure, rejection, contempt, disability to fulfill the office duties, or act in accordance with the principles set in KAA statute and regulations or this Law.</p> | <p>odluku o akreditaciji institucija visokog obrazovanja i njihovih programa.</p> <p>9. Članovi Odbora AKA-a ne mogu biti visoki javni službenici koji imaju visoke politike pozicije u institucijama Republike Kosovo.</p> <p>10. Na predlog Odbora AKA-a ili ministra, Vlada može razrešiti člana Odbora pre isteka njegovog/njenog mandata iz sledećih razloga.</p> <p>10.1. Kazna krivičnog dela koja je kažnjiva zatvorom;</p> <p>10.2. Nesposobnost obavljanja funkcija pozicije zbog fizike ili mentalne nesposobnosti, koja je dokumentovana izveštajem od najmanje dva (2) lekara, koji su određeni prema važećem zakonodavstvu;</p> <p>10.3. Neuspeh, odbijanje, nepoštovanje, kontinuirana nesposobnost za ispunjavanje obaveza pozicije, ili delovanje u skladu sa principima koji su određeni u statutu i uredbama AKA-a ili ovim Zakonom.</p> |
|---|---|---|

| | | |
|--|--|---|
| <p>11. Zyra administrative e AKA-së udhëhiqet nga Drejtori që është përgjegjës për administrimin, funksionimin dhe menaxhimin e AKA-së.</p> <p>12. Pozita e Drejtorit aprovohet nga Bordi i AKA-së. Emërimi, shkarkimi, funksionet dhe përgjegjësitë e Drejtorit rregullohen me dispozitat përkatëse në fuqi në Republikën e Kosovës dhe statutit të AKA-së.</p> | <p>11. The administrative office of KAA is headed by a Director who is responsible for administration, functioning and management.</p> <p>12. The Director must be approved by the KAA Board. Its appointment, discharge, functions and responsibilities are regulated by the relevant applicable provisions in the Republic of Kosova and by KAA's statute.</p> | <p>11. Administrativnom kancelarijom AKA rukovodi direktor koji je odgovoran za administraciju, funkcionisanje i upravljanje.</p> <p>12. Odbor AKA mora odobriti direktora. Njegovo imenovanje, razrešenje, funkcije i odgovornosti regulisane su odgovarajućim važećim propisima u Republici Kosovo i statutom AKA.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 14 Akreditimi i institucioneve dhe programeve të arsimit të lartë</p> <p>1. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë të cilat funksionojnë në Republikën e Kosovës i nënshtrohen vlerësimit të cilësisë siç është përcaktuar dhe ekzekutuar nga AKA, në përputhje me këtë Ligj dhe aktet nën-ligjore. AKA kryen akreditimin institucional dhe akreditimin e programit si parakusht kryesor për marrjen e licencës nga Ministri.</p> <p>2. Akreditimi institucional është procesi i certifikimit të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë në përputhje me standardet e cilësisë dhe procedurat e përcaktuara nga AKA-ja.</p> | <p style="text-align: center;">Article 14 Accreditation of higher education institutions and programmes</p> <p>1. All institutions of higher education operating in the Republic of Kosova are subject to quality assessment as designed and executed by KAA in accordance to this Law and with sub-legal acts. KAA carries out institutional accreditation and programme accreditation as main preconditions for the delivery of a licence by the Minister.</p> <p>2. Institutional accreditation is the process of certification of quality of higher education institutions in accordance with the quality standards and procedures defined by KAA.</p> | <p style="text-align: center;">Član 14 Akreditacija Institucija I Programa Visokog Obrazovanja</p> <p>1. Sve institucije visokog obrazovanja koje funkcionišu u Republici Kosovo podležu procedurama procene kvaliteta kao što je određeno i izvršeno od strane AKA, u skladu sa ovim Zakonom i podzakonskim aktima. AKA obavlja institucionalnu akreditaciju i akreditaciju programa kao glavne preduslove za dobijanje licence od strane ministra.</p> <p>2. Institucionalna akreditacija je proces sertifikacije kvaliteta institucija visokog obrazovanja u skladu sa standardima kvaliteta i postupcima definisanih od strane AKA.</p> |

| | | |
|--|--|---|
| <p>3. Akreditimi i programeve të studimit është procesi i certifikimit të cilësisë së tyre në përputhje me standardet e cilësisë dhe procedurat e përcaktuara nga AKA-ja..</p> <p>4. Akreditimi institucional është parakusht për akreditimin e programeve të studimit.</p> <p>5. Akreditimi dhe riakreditimi i një institucioni apo programi të arsimit të lartë, është i vlefshëm për një periudhë të caktuar kohore, jo më shumë se pesë (5) vite, dhe institucionet e arsimit të lartë duhet të kërkojnë ripërtëritjen e saj në kohën e duhur para skadimit të saj.</p> <p>6. Procedurat e akreditimit dhe riakreditimit duhet të përfshijnë një rishikim të raportit të vetë-vlerësimit të institucionit nga një ekip i kualifikuar për rishikimin, i caktuar nga AKA në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe një vizitë në institucion.</p> <p>7. Një institucion i arsimit të lartë që kërkon akreditim duhet të paraqes një kërkesë te AKA të paktën një (1) vit përpara datës së planifikuar të akreditimit.</p> | <p>3. Accreditation of study programs is the process of the certification of the quality of such programmes in accordance with the quality standards and procedures defined by KAA.</p> <p>4. Institutional accreditation is a precondition for the accreditation of study programs.</p> <p>5. The accreditation and reaccreditation of a higher education institution or programme is valid for a defined period of time, not exceeding five (5) years, and higher education institutions must seek its renewal in due time before its expiration.</p> <p>6. Accreditation and reaccreditation procedures must include a review of the institution's self-assessment report by a qualified review team set up by KAA in accordance with international standards and a site visit to the institution.</p> <p>7. A higher education institution that seeks accreditation must present a request to KAA at least one (1) year before the expected date of accreditation.</p> | <p>3. Akreditacija studijskih programa je proces sertifikacije kvaliteta tih programa u skladu sa standardima kvaliteta i postupcima definisanih od strane AKA.</p> <p>4. Institucionalna akreditacija je preduslov za akreditaciju studijskih programa.</p> <p>5. Akreditacija i ponovna akreditacija institucije ili programa visokog obrazovanja važi za određeni vremenski period, ne duži od pet (5) godina, i institucije visokog obrazovanja moraju da traže svoju obnovu u dogledno vreme pre njenog isteka.</p> <p>6. Procedure akreditacije i ponovne akreditacije treba da obuhvataju razmatranje izveštaja institucije o samoprocenjivanju od strane kvalifikovanog tima za razmatranje, kojeg je odredila AKA, u skladu sa međunarodnim standardima, i posetu instituciji.</p> <p>7. Institucija visokog obrazovanja koja traži akreditaciju mora podneti zahtev u AKA najmanje jednu (1) godinu pre očekivanog datuma akreditacije.</p> |
|--|--|---|

| | | |
|--|--|--|
| <p>8. Riakreditimi i një institucioni apo i një ose më shumë programeve të tij, mund të kërkohej nga AKA apo nga Ministri në çdo kohë, edhe para skadimit të afatit të akreditimit.</p> <p>9. Një institucion i arsimit të lartë nuk mund ta shpallë veten si “i akredituar”, nëse nuk është akredituar në Kosovë sipas procedurave të përcaktuara në këtë Ligj dhe me instrumente të tjera të nxjerra në bazë të tij. Nëse është akredituar për programe nga një vend i huaj apo organizatë tjetër, institucioni duhet të dëshmojë dhe deklarojë hapur origjinën e një akreditimi të tillë dhe dëshmia e ofruar duhet të miratohet nga AKA si akreditim në Kosovë.</p> <p>10. Standardet për të cilat është bazuar akreditimi duhet të përmbushen për të gjithë periudhën kohore të vlefshmërisë së akreditimit. Në rast se AKA konstaton shmangie nga këto standarde, ka të drejtë të vendos kushte dhe afate kohore për përmbushjen e tyre. Dështimi për të përmbushur këto kushte në afat kohore të caktuara nga AKA shpie në tërheqjen e akreditimit nga AKA.</p> <p>11. Institucionet e arsimit të lartë mund të ofrojnë programe të përbashkëta apo me diploma të dyfishta, në bashkëpunim me</p> | <p>8. The reaccreditation of an institution or of one or more of its programs may be required by KAA or by the Minister at any time, even before the expiration of the accreditation term.</p> <p>9. An institution of higher education cannot declare itself as "accredited" if it is not accredited in Kosovo according to procedures defined in this Law and in other instruments issued under it. If it is accredited for programs in a foreign country or other organization, an institution must demonstrate and declare publicly the origin of such accreditation and the evidence provided must be approved in Kosovo by the KAA.</p> <p>10. The standards on which the accreditation is awarded must be met throughout the whole period of validity of the accreditation. In case KAA determine deviations from these standards, it establishes conditions and time limits for their fulfilment. Failure to fulfil these conditions within the defined time limit leads to the withdrawal of accreditation by KAA.</p> <p>11. Higher education institutions may offer joint or double-degree programmes in cooperation with national or foreign</p> | <p>8. Ponovna akreditacija institucije ili jednog ili više njenih programa može biti zatražena od AKA ili ministra u bilo kom trenutku, čak i pre isteka roka akreditacije.</p> <p>9. Jedna institucija visokog obrazovanja ne može proglasiti sebe “akreditovanom” ukoliko nije akreditovana na Kosovu, prema procedurama određenim u ovom Zakonu i drugim instrumentima izdatim na osnovu njega. Ukoliko je akreditovana za programe u stranoj zemlji ili drugoj organizaciji, institucija treba da dokaže i javno objavi poreklo takve akreditacije i AKA treba da usvoji pružene dokaze na Kosovu.</p> <p>10. Standardi za koje se dodeljuje akreditacija moraju biti ispunjeni tokom celog perioda važenja akreditacije. U slučaju da AKA odredi odstupanja od ovih standarda, Agencija uspostavlja uslove i rokove za njihovo ispunjenje. Neuspeh da se ispune ovi uslovi u predviđenom roku dovodi do povlačenja akreditacije od strane AKA.</p> <p>11. Institucije visokog obrazovanja mogu ponuditi zajedničke ili studijske programe sa duplim diplomama u saradnji sa</p> |
|--|--|--|

| | | |
|--|--|--|
| <p>institucionet partnere vendore apo të huaja dhe të marrin akreditimin nga AKA për programe të tilla.</p> <p>12. Vendimi për akreditim të programit të studimit duhet të përcaktojë numrin maksimal të studentëve që mund të pranohen për atë program, në përputhje me kriteret dhe standardet e AKA-së.</p> <p>13. Vendimi për akreditimin është pozitiv ose negativ. Në rast se institucioni i arsimit të lartë nuk akreditohet, ai nuk mund të organizojë studime dhe nuk mund të lëshojë diploma për programet e studimit që janë refuzuar.</p> <p>14. Vetëm ato grada dhe diploma që lëshohen nga institucioni i akredituar dhe licencuar i arsimit të lartë njihen nga Qeveria e Republikës së Kosovës për qëllime punësimi, për marrjen e funksioneve publike ose për mbështetje të njohjes ndërkombëtare. Pavarësisht kësaj rregulle të përgjithshme, Qeveria e Republikës së Kosovës do të ketë të drejtë të krijojë një masë afirmative për validimin e diplomave dhe gradave për të mbështetur parimet e barazisë, të drejtës për arsimim dhe punësim, pjesëmarrjes dhe mosdiskriminimit.</p> <p>15. Nëse një institucion i licencuar i</p> | <p>partner institutions and get accreditation from KAA for such programmes.</p> <p>12. The decision for accreditation of study program must determine the maximum number of student's that can be admitted to the program, in accordance with KAA's criteria and standards.</p> <p>13. Decision for accreditation is positive or negative. If the higher education institution is not accredited, it cannot organize studies and cannot issue diplomas for study programs that were rejected.</p> <p>14. Only those degrees and diplomas that are issued by an accredited and licensed institution of higher education are recognized by the Government of the Republic of Kosovo for purpose of employment, obtaining public functions or for support of their international recognition. Notwithstanding this general rule the Government of the Republic of Kosovo shall have the right to establish an affirmative measure for validating diplomas and degrees to uphold principles of equality, right to education and employment, participation and non-discrimination.</p> <p>15. If a licensed institution of higher</p> | <p>domaćim i stranim partnerskim institucijama i dobiti akreditaciju od AKA za takve programe.</p> <p>12. Odluka o akreditaciji studijskog programa mora da odredi maksimalan broj studenata koji mogu biti primljeni za taj program.</p> <p>13. Odluka o akreditaciji je pozitivna ili negativna. Ukoliko institucija visokog obrazovanja nije akreditovana, ne može organizovati studije i ne može izdati diplome za studijske programe koji su odbijeni.</p> <p>14. Vlada Republike Kosovo priznaje samo one stepene i diplome koje izdaju akreditovane i licencirane institucije visokog obrazovanja u cilju zapošljavanja, dobijanja javnih funkcija ili za podršku njihovog međunarodnog priznanja. Bez obzira na to, ovo opšte pravilo Vlade Republike Kosovo ima pravo na osnivanje afirmativnih mera za potvrđivanje diploma i stepena radi poštovanja načela jednakosti, prava na obrazovanje i zapošljavanje, učešće i nediskriminaciju.</p> <p>15. Ukoliko jedna licencirana institucija</p> |
|--|--|--|

| | | |
|--|--|--|
| <p>arsimit të lartë dështon të arrijë akreditimin apo riakreditimin institucional, kjo do të rezultojë me organizimin e një procedure të re për akreditim brenda jo më shumë se një (1) viti.</p> <p>16. Nëse institucioni dështon për herë të dytë në marrjen e akreditimit, i revokohet licenca. Për të kundërshtuar revokimin e licencës së tij, institucioni mund të parashtroj ankesë në Gjykatë në pajtim me Ligjin për Procedurën Administrative dhe Ligjin për Konfliktin Administrativ.</p> <p>17. Shpenzimet për vlerësimin e jashtëm të cilësisë dhe akreditimin mbulohen nga vetë institucionet e arsimit të lartë, sipas tarifave të përcaktuara nga AKA.</p> | <p>education fails to achieve institutional accreditation or re-accreditation, this shall result in the organization of a new procedure of accreditation, within not more than one (1) year.</p> <p>16. If an institution fails for the second time in obtaining the accreditation, the license is revoked. To appeal the revoking of its license, an institution may present complaint to the Court conform to the Law on Administrative Procedures and the Law on Administrative Conflicts.</p> <p>17. Expenditures for external quality evaluation and accreditation are covered by higher education institutions, according to the fees stipulated by KAA.</p> | <p>visokog obrazovanja ne uspe da postigne institucionalnu akreditaciju ili ponovnu akreditaciju, to će rezultirati organizovanjem jedne nove procedure za akreditaciju, najkasnije u roku od jedne (1) godine.</p> <p>16. Ukoliko institucija ne uspe po drugi put da dobije akreditaciju, oduzima joj se licenca. Da bi se osporilo oduzimanje njene licence, institucija može da podnese žalbu Sudu u skladu sa Zakonom o administrativnom postupku i Zakonom o upravnom sporu.</p> <p>17. Troškove za spoljnu evaluaciju kvaliteta i akreditaciju pokriva institucija visokog obrazovanja, u skladu sa naknadama koje je utvrdila AKA.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 15 Licencimi i institucioneve të arsimit të lartë</p> <p>1. Licencimi është procesi me të cilën Ministri i jep leje qeveritare një institucioni të arsimit të lartë, qoftë publik apo jopublik, që të ushtrojë aktivitetin e tij arsimor/akademik. Licencimi është i domosdoshëm për të gjitha institucionet e arsimit të lartë të cilat dëshirojnë të ofrojnë grada, diploma apo certifikata të arsimit të</p> | <p style="text-align: center;">Article 15 Licensing of higher education institutions</p> <p>1. Licensing is the process by which the Minister grants governmental permission to a higher education institution, both public and non-public, to exercise their educational/ academic activity. Licensing is compulsory for all higher education institutions who want to deliver a Kosova degree, diploma or certificate of higher</p> | <p style="text-align: center;">Član 15 Licenciranje institucija visokog obrazovanja</p> <p>1. Licenciranje je proces kojim ministar daje službeno dozvolu jednoj instituciji visokog obrazovanja, bilo da je javna ili nejavna, da obavlja njenu obrazovnu/akademsku aktivnost. Licenciranje je neophodno za sve institucije visokog obrazovanja koje žele da pružaju stepene, diplome ili sertifikate</p> |

| | | |
|---|---|--|
| <p>lartë në Kosovë, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj të veçantë;</p> <p>2. Një institucion i arsimit të lartë nuk mund të fillojë punën, në asnjë rrethanë, pa u pajisur paraprakisht me licencë nga Ministri.</p> <p>3. Institucionet e arsimit të lartë të cilat kanë marrë akreditimin nga AKA, duhet të aplikojnë për licencim nga Ministri.</p> <p>4. Licenca i jepet çdo institucioni që aplikon dhe i plotëson kriteret, jo më vonë se tre (3) muaj nga data e aplikimit. Licencat kanë kohëzgjatje të kufizuar, jo më gjatë se pesë (5) vite, varësisht nga kohëzgjatja e akreditimit të tyre nga AKA. Licencat janë të ri-përtëritshme.</p> <p>5. Në marrjen e vendimit për të licencuar një institucion të arsimit të lartë, Ministri do të ndërmarrë inspektimet e nevojshme për të nxjerr një gjykim të qartë të bazuar në dëshmi. Dëshmi të tilla mund të ofrohen në vlerësimet e AKA-së dhe vendimet e akreditimit, por mund po ashtu të kërkohen përmes agjencive të tjera me ekspertizë të veçantë.</p> <p>6. Përveç akreditimit institucional nga</p> | <p>education, unless defined otherwise by a special law;</p> <p>2. A higher education institution cannot begin to function, not in any circumstances, without being equipped in advance with a license from the Minister.</p> <p>3. Higher education institutions that have obtained accreditation by KAA, must apply for a license from the Minister.</p> <p>4. The license is given to each applicant institution that meets the criteria, no later than three (3) months after the date of application. Licenses have a limited duration no longer than five (5) years, depending on the duration of the accreditation by KAA. The licenses are renewable.</p> <p>5. In its decision to license a higher education institution, the Minister will undertake the inspections necessary to get a clear judgement based on evidence. Such evidence may be provided in KAA evaluations and accreditation decisions, but may also be sought through other agencies with special expertise.</p> <p>6. Besides institutional accreditation by</p> | <p>visokog obrazovanja na Kosovu, osim ukoliko nije drugačije određeno posebnim zakonima;</p> <p>2. Institucija visokog obrazovanja ne može da krene sa radom, ni pod kojim okolnostima, bez prethodnog dobijanja licence od strane ministra.</p> <p>3. Institucije visokog obrazovanja koje su dobile akreditaciju od AKA moraju se prijaviti za licencu od ministra.</p> <p>4. Licenca se daje svakoj instituciji kandidatu koja ispunjava kriterijume, najkasnije u roku od tri (3) meseca nakon datuma prijave. Licence imaju ograničeno trajanje na ne duže od pet (5) godina, u zavisnosti od trajanja akreditacije od strane AKA. Dozvole su obnovljive.</p> <p>5. U svojoj odluci da izda licencu instituciji visokog obrazovanja, ministar će preduzeti neophodne inspekcije neophodne za dobijanje jasne presude na osnovu dokaza. Takvi dokazi mogu biti obezbeđeni u odlukama AKA o evaluaciji i akreditaciji, ali se takođe mogu tražiti preko drugih agencija sa posebnim stručnošću.</p> <p>6. Osim institucionalne akreditacije od</p> |
|---|---|--|

| | | |
|---|--|--|
| <p>AKA, si parakusht kryesor, që kërkon në veçanti një sistem të mirëfilltë të sigurimit të brendshëm të cilësisë, kriteret e licencimit përfshijnë për të gjitha kategoritë e institucioneve të arsimit të lartë dispozita lidhur me:</p> <p>6.1. Aprovimin e statuteve të tyre;</p> <p>6.2. Përshtatshmërinë e mjediseve dhe pajisjeve, duke përfshirë kushtet teknike për qasje të personave me aftësi të kufizuara;</p> <p>6.3. Realizueshmërinë dhe qëndrueshmërinë financiare, përfshirë përkushtimin e institucionit për krijimin e një fondi për përkrahje të studentëve;</p> <p>6.4. Një plan financiar dhe zhvillimor tre (3) vjeçar;</p> <p>7. Institucioni i licencuar i arsimit të lartë mund të aplikoj në çdo kohë në Ministri për ndryshimin e kushteve në licencën e tij.</p> <p>8. Ministri mund t’ia revokojë licencën institucionit në rast se ka dëshmi se institucioni nuk i plotëson apo ka pushuar së plotësuari kriteret për standardet e licencimit. Dëshmi të tilla duhet të</p> | <p>KAA as main precondition, which requires in particular a sound internal quality assurance system, licensing requirements for all categories of higher education institutions must include provisions related to:</p> <p>6.1. The approval of their statutes;</p> <p>6.2. The adequacy of facilities and equipment, including technical requirements for access of persons with disabilities;</p> <p>6.3. The financial feasibility and sustainability, including the institution's commitment for the creation of a fund for supporting students;</p> <p>6.4. A suitable three (3) year development and financing plan.</p> <p>7. A licensed higher education institution can apply at any time to the Ministry for changes in the terms in its license.</p> <p>8. The Minister can revoke an institution’s license in case there is evidence that the institution is not, or no longer meeting the requirements for licensing. Such evidence is to be presented via an inspection report</p> | <p>strane AKA, kao glavni preduslov, koja posebno zahteva dobar sistem unutrašnjeg osiguranja kvaliteta, kriterijumi licenciranja za sve kategorije institucija visokog obrazovanja moraju da obuhvataju i odredbe u vezi:</p> <p>6.1. Usvajanja njihovih statuta;</p> <p>6.2. Adekvatnosti objekata i opreme, uključujući i tehničke uslove za pristup lica sa ograničenim sposobnostima;</p> <p>6.3. Finansijske izvodljivosti i održivosti, uključujući posvećenost institucije za stvaranje fonda za podršku studentima;</p> <p>6.4. Tro (3) godišnjeg plana razvoja i finansijskog plana;</p> <p>7. Licencirana institucija visokog obrazovanja može se prijaviti u bilo kom trenutku u Ministarstvu za promene u uslovima svoje licence.</p> <p>8. Ministar može oduzeti licencu instituciji u slučaju da postoji dokaz da institucija ne ispunjava ili više ne ispunjava uslove za licenciranje. Takav nedostatak dokaza treba da bude predstavljen preko izveštaja</p> |
|---|--|--|

| | | |
|--|--|--|
| <p>prezantohen përmes raportit përfundimtar të inspektimit nga Ministria apo AKA me rekomandime të qarta për heqje të licencës. Në rast të revokimit të licencës, institucioni gëzon të drejtën që të parashtojë ankesë pranë gjykatës kompetente por vetëm për shkak të mangësive procedurale.</p> <p>9. Licencimi i institucioneve publike të arsimit të lartë:</p> <p>9.1. Si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i përcaktuar në këtë nen, institucionet e reja publike të arsimit të lartë të themeluara me ligj të veçantë apo me vendim të Qeverisë dhe të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës konsiderohen të jenë të licencuar për programet e akredituara për një periudhë fillestare prej pesë (5) vitesh, nga dita e ratifikimit të vendimit ose miratimit të ligjit;</p> <p>9.2. Para skadimit të licencës fillestare, institucioni i ri i arsimit të lartë duhet të akreditohet nga AKA ose ndonjë agjenci tjetër për sigurim të cilësisë që është e aprovuar nga AKA, si në nivel të institucionit ashtu dhe për programet e ndryshme të tij;</p> <p>9.3. Kur institucioni i ri publik i arsimit</p> | <p>by the Ministry or KAA with a clear recommendation for the withdrawal of the license. In case of revocation of the license, the institution has the right to file a complaint at competent court, but only on the grounds of procedural deficiencies.</p> <p>9. Licensing of public higher education institutions:</p> <p>9.1. As an exception to the general rule set out in this article, new public higher education institutions established by a special law or by decision of the Government and ratified by the Assembly of the Republic of Kosova are considered as licensed for accredited programmes for an initial period of five (5) years from the date of Ratification of the Decision or Approval of the law;</p> <p>9.2. Before the expiration of the initial licence, the new higher education institution must be accredited by KAA or another quality assurance agency approved by KAA, both at the institutional level and for its various programs;</p> <p>9.3. When the new public higher</p> | <p>inspekcije Ministarstva ili AKA sa jasnom preporukam za oduzimanje licence. U slučaju oduzimanja licence, institucija ima pravo da uložiti žalbu nadležnom sudu, ali samo na osnovu proceduralnih nedostataka.</p> <p>9. Licenciranje javnih institucija visokog obrazovanja:</p> <p>9.1. Kao izuzetak od opšteg pravila izloženog u ovom članu, nove javne institucije visokog obrazovanja osnovane posebnim zakonom ili odlukom Vlade i ratifikovane od strane Skupštine Republike Kosovo smatraju se licenciranim za akreditovane programe za početni period od pet (5) godina, od dana ratifikacije odluke ili usvajanja zakona;</p> <p>9.2. Pre isteka inicijalne dozvole, nova institucija visokog obrazovanja mora da bude akreditovana od strane AKA ili druge agencije za osiguranje kvaliteta odobrene od strane AKA, kako na institucionalnom nivou, tako i za svoje različite programe;</p> <p>9.3. Kada nova javna institucija visokog</p> |
|--|--|--|

| | | |
|--|--|--|
| <p>të lartë merr akreditimin institucional, ai konsiderohet i licencuar pa kufizim kohor, por vetëm për ato programe për të cilat është i akredituar.</p> <p>10. Licencimi i institucioneve jopublike të arsimit të lartë:</p> <p>10.1. Licencimi i mundësohet vetëm atyre institucioneve jopublike të arsimit të lartë që gëzojnë akreditimin institucional nga AKA dhe vetëm për ato programe për të cilat institucioni ka arritur akreditimin e programit nga AKA apo ndonjë organ tjetër i njohur për akreditim i aprovuar nga AKA;</p> <p>10.2. Për licencimin e tyre, institucionet jopublike të arsimit të lartë duhet të plotësojnë disa kërkesa të veçanta, përveç kërkesave të përgjithshme të përcaktuara në këtë nen. Këto kërkesa të veçanta janë dhënë në hollësi në seksionin e këtij Ligji, që përcakton organizimin dhe funksionimin e institucioneve jopublike të arsimit të lartë (Kapitulli XI);</p> <p>10.3. Nëse Ministri nuk i jep licencë një institucioni jopublik të arsimit të lartë, institucioni nuk mund të regjistrojë asnjë student. Nëse licenca është tërhequr nga</p> | <p>education institution obtains the institutional accreditation, it is considered licensed without time limitation, but only for those programs for which it is accredited.</p> <p>10. Licensing of non-public higher education institutions:</p> <p>10.1. Licensing is only possible for non-public higher education institutions that enjoy institutional accreditation by KAA and only for those programmes for which the institution has achieved program accreditation from KAA or another recognized body for accreditation approved by the KAA;</p> <p>10.2. For the licensing of non-public higher education institutions, they must fulfil some specific requirements on top of the general requirements set out in this article. These specific requirements are detailed in the section of this Law dealing with the organisation and functioning of non-public higher education institutions (Chapter XI);</p> <p>10.3. If the Minister does not give a licence to a non-public higher education institution, the institution cannot enrol any student. If the license is withdrawn</p> | <p>obrazovanja dobije institucionalnu akreditaciju, smatra se licenciranom bez vremenskog ograničenja, ali samo za one programe za koje je akreditovana.</p> <p>10. Licenciranje nejavnih institucija visokog obrazovanja:</p> <p>10.1. Licenciranje je moguće samo za nejavne institucije visokog obrazovanja koje uživaju institucionalnu akreditaciju AKA i samo za one programe za koje je institucija postigla program akreditacije od AKA ili drugog priznatog organa za akreditaciju odobrenog od strane AKA.</p> <p>10.2. Za licenciranje nejavnih institucija visokog obrazovanja, moraju se ispuniti neki specifični zahtevi na vrhu opštih uslova navedenih u ovom članu. Ovi posebni zahtevi su detaljno opisani u delu ovog Zakona koji se bavi organizacijom i funkcionisanjem nejavnih institucija visokog obrazovanja (Poglavlje XI).</p> <p>10.3. Ako ministar ne da licencu nejavnoj instituciji visokog obrazovanja, institucija ne može da upiše nijednog studenta. Ako je licenca povučena od institucije koja je</p> |
|--|--|--|

| | | |
|---|---|--|
| <p>një institucion i cili paraprakisht ka qenë i licencuar, një institucion i tillë nuk mund të pranojë studentë të rinj dhe institucioni duhet të bëjë marrëveshje për të siguruar që studentët e tij aktual, nëse ka të tillë, mund të përfundojnë me sukses programin e tyre të studimeve në ndonjë institucion tjetër të akredituar.</p> | <p>from an institution which was previously licensed, such an institution cannot admit new students, and the institution should make agreements to ensure that its current students, if there are any, can complete with success their study program at any other accredited institution.</p> | <p>prethodno bila licencirana, takva institucija ne može da prima nove studente, i institucija treba da se dogovori da obezbedi da njeni sadašnji studenti, ukoliko ih ima, mogu uspešno da završe njihove studijske programe u bilo kojoj drugoj akreditovanoj instituciji.</p> |
| <p>KAPITULLI V: INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË</p> | <p>CHAPTER V: PUBLIC HIGHER EDUCATION INSTITUTIONS</p> | <p>POGLAVLJE V: JAVNE INSTITUCIJE VISOKOG OBRAZOVANJA</p> |
| <p>Neni 16 Themelimi i institucioneve të reja publike të arsimit të lartë</p> | <p>Article 16 Creation of new public higher education institutions</p> | <p>Član 16 Stvaranje novih javnih institucija visokog obrazovanja</p> |
| <p>1. Institucionet e reja publike të arsimit të lartë, të çdo lloji, mund të themelohen vetëm me ligj ose me vendim të Qeverisë, të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Akti i themelimit të një institucioni të ri publik të arsimit të lartë duhet të përcaktojë qartë llojin, emrin dhe programet e përkohshme të institucionit të ri publik të arsimit të lartë në përputhje me këtë Ligj.</p> <p>3. Për çdo institucion të ri publik të arsimit</p> | <p>1. New public higher education institutions of any type can only be created by law or by a decision of the Government ratified by the Assembly of the Republic of Kosova.</p> <p>2. The Act creating a new public higher education institution must clearly establish the provisional type, name and programs of the new public higher education institution in accordance with this Law.</p> <p>3. For each new public institution of</p> | <p>1. Nove javne institucije visokog obrazovanja bilo koje vrste mogu biti stvorene samo zakonom ili odlukom Vlade koju je ratifikovala Skupština Republike Kosovo.</p> <p>2. Zakon o stvaranju nove javne institucije visokog obrazovanja mora jasno utvrditi privremenu vrstu, ime i programe nove javne institucije visokog obrazovanja u skladu sa ovim Zakonom.</p> <p>3. Za svaku novu javnu instituciju visokog</p> |

| | | |
|---|---|---|
| <p>të lartë, Ministri emëron Këshillin Themelues të institucionit për një mandat deri në dy (2) vite, me detyrë për organizimin e punës së institucionit dhe themelimin e organeve të rregullta kryesore të institucionit.</p> | <p>higher education, the Minister appoints the Establishing Council of the institution for a mandate of up to two (2) years, with the task of organizing the work in the institution and setting in place the regular main bodies of the institution.</p> | <p>obrazovanja, ministar imenuje Savet institucije za mandat do dve (2) godine, sa zadatkom da organizuje rad u instituciji i uspostavi redovna glavna tela institucije.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 17 Bashkimi, ndarja dhe mbyllja e institucioneve publike të arsimit të lartë</p> | <p style="text-align: center;">Article 17 Merger, splitting and closure of public institutions of higher education</p> | <p style="text-align: center;">Član 17 Spajanje, razdvajanje i zatvaranje javnih institucija visokog obrazovanja</p> |
| <p>1. Nëse Ministri konstaton se është në interesin publik, Qeveria e Republikës së Kosovës mund të vendosë të bashkojë, ndajë ose mbyllë një institucion publik të arsimit të lartë. Në këtë rast, Ministri bën publike arsyet e propozimit dhe publikon një dokument për diskutim dhe konsultohet me organin drejtues të të gjitha institucioneve të cilat mund të ndikoj ky vendim si dhe me AKA-në. Vendimi i Qeverisë për të bashkuar, ndarë ose mbyllur një institucion, hyn në fuqi pas ratifikimit nga Kuvendi.</p> <p>2. Organi drejtues i një institucioni publik të arsimit të lartë mund të propozojë bashkimin, ndarjen ose mbylljen, që duhet të miratohet nga Ministri pas konsultimit me AKA-në. Ky vendim hyn në fuqi pas ratifikimit nga Kuvendi.</p> | <p>1. If the Minister ascertains that it is in the public interest, the Government of the Republic of Kosovo may decide to merge, split or close a public institution of higher education. In this case the Minister makes public the reasons for the proposal and publishes a document for discussion and consults the governing body of all institutions that may be affected as well as KAA. The decision of the Government to merge, split or close an institution enters into force after ratification by the Assembly.</p> <p>2. The governing body of a public higher education institution may propose its merger, splitting or closure, which must be approved by the Minister after consultation with KAA. This decision shall enter into force after ratification by the Assembly.</p> | <p>1. Ako ministar utvrdi da je u javnom interesu, Vlada Republike Kosova može odlučiti o spajanju, razdvajanju ili zatvaranju javne institucije visokog obrazovanja. U ovom slučaju ministar iznosi javne razloge za takav predlog. i objavljuje dokument za diskusiju i konsultuje upravljačko telo svih institucija koje mogu biti ugrožene, kao i AKA. Odluka Vlade da spoji, razdvoji ili zatvori instituciju stupa na snagu nakon ratifikacije u Skupštini.</p> <p>2. Upravni organ javne institucije visokog obrazovanja može sam predložiti svoje spajanje, razdvajanje ili zatvaranje, koje mora da odobriti ministar nakon konsultacija sa AKA. Ova odluka stupa na snagu nakon ratifikacije u Skupštini.</p> |
| | | |

| | | |
|--|--|---|
| <p>3. Në rast se një institucion publik i arsimit të lartë mbyllet, ndahet ose bashkohet, Ministri përcakton të gjitha çështjet që lidhen me pronësinë, detyrimet dhe obligimet e vazhdueshme ndaj studentëve të regjistruar në atë institucion.</p> <p>4. Dokumentacioni i institucionit të mbyllur duhet të dorëzohet tek Ministria, në bazë të akteve nënligjore të përcaktuara nga Ministri.</p> | <p>3. If a public institution of higher education gets closed, split or merged, the Minister determines all matters relating to ownership, liabilities and ongoing obligations to students enrolled at the institution.</p> <p>4. The documentation of the closed institution must be submitted to the Ministry based on sub-legal acts defined by the Minister.</p> | <p>3. Ako javna institucija visokog obrazovanja bude zatvorena, razdvojena ili spojena, ministar određuje sva pitanja koja se odnose na vlasništvo, obaveze i tekuće obaveze prema upisanim studentima u instituciji.</p> <p>4. Dokumentacija zatvorene institucije mora biti dostavljena ministarstvu na osnovu podzakonskih akata definisanih od strane ministra.</p> |
| <p>Neni 18 Autonomia e institucioneve publike të arsimit të lartë</p> | <p>Article 18 Autonomy of public higher education institutions</p> | <p>Član 18 Autonomnost javne institucije visokog obrazovanja</p> |
| <p>1. Shteti ka përgjegjësitë dhe detyrimet për të garantuar autonominë institucionale dhe lirinë akademike të institucioneve publike të arsimit të lartë.</p> <p>2. Të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Kosovës gëzojnë autonomi institucionale, liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>3. Si pjesë e autonomisë së tyre institucionale, institucionet publike të</p> | <p>1. The state assumes responsibilities and obligations to guarantee the institutional autonomy and academic freedom of public institutions of higher education.</p> <p>2. All public institutions of higher education of the Republic of Kosova enjoy institutional autonomy, academic freedom, financial and organizational autonomy, as well as autonomy in the selection of personnel, in accordance with applicable laws.</p> <p>3. As part of their institutional autonomy, public higher education institutions have</p> | <p>1. Država preuzima odgovornosti i obaveze da garantuje institucionalnu autonomiju i akademsku slobodu javnih institucija visokog obrazovanja.</p> <p>2. Sve javne institucije visokog obrazovanja Republike Kosovo uživaju institucionalnu autonomiju, akademsku slobodu, finansijsku i organizacionu autonomiju, kao i autonomiju u izboru osoblja, u skladu sa važećim zakonima.</p> <p>3. Kao deo njihove institucionalne autonomije, javne institucije visokog</p> |

| | | |
|---|---|---|
| <p>arsimit të lartë në veçanti kanë të drejtat në vijim, që ushtrohen në pajtim me këtë Ligj:</p> <p>3.1. Të zgjedhin autoritetet drejtuese dhe menaxhuese, sipas këtij Ligji;</p> <p>3.2. Të organizojnë strukturat e brendshme të tilla si: fakultetet, departamentet, institutet, njësitë për menaxhim dhe mbështetje dhe qendrat e tjera, me interes të përbashkët të studimit, hulumtimit dhe zhvillimit;</p> <p>3.3. Të zgjedhin dhe gradojnë mësimdhënësit, hulumtuesit dhe personelin tjetër, në përputhje me këtë Ligj;</p> <p>3.4. Të përcaktojnë kushtet dhe kriteret për pranimin e studentëve;</p> <p>3.5. Të vendosin sistemin e tyre të brendshëm për sigurim të cilësisë, përfshirë edhe ato që lidhen me vlerësimin e mësimdhënësve dhe studentëve;</p> <p>3.6. Të hartojnë dhe zbatojnë kurrikulat akademike dhe projektet e kërkimeve shkencore, në konsultim me partnerët</p> | <p>in particular the following rights, to be exercised in accordance with this Law:</p> <p>3.1.To select their governing and management bodies as defined in this Law;</p> <p>3.2.To organize internal structures such as faculties, departments, institutes, management and support units and other centres, for the common interests of study, research and development;</p> <p>3.3.To select and promote teachers, researchers and other personnel, in accordance with this Law;</p> <p>3.4.To define the conditions and criteria regarding the admission of students;</p> <p>3.5.To determine their internal quality assurance system, including with respect to teacher and student assessment;</p> <p>3.6.To define and implement academic curricula and scientific research projects, in consultation with local and international partners;</p> | <p>obrazovanja imaju posebno sledeća prava, koja obavljaju u skladu sa ovim Zakonom:</p> <p>3.1. Da izaberu svoje organe upravljanja i rukovođenja kao što je definisano u ovom Zakonu;</p> <p>3.2 Da organizuju unutrašnje strukture kao što su fakulteti, departmani, instituti, da upravljaju i podrže jedinice i druge centre, za zajedničke interese studija, istraživanja i razvoja;</p> <p>3.3 Da izaberu i promovišu nastavnike, istraživače i drugo osoblje, u skladu sa ovim Zakonom;</p> <p>3.4. Da definišu uslove i kriterijume u pogledu prijema studenata;</p> <p>3.5. Da utvrde svoj sistem unutrašnjeg osiguranja kvaliteta, uključujući u vezi ocenjivanja nastavnika i studenata;</p> <p>3.6. Da definišu i sprovedu akademski nastavni plan i program i naučno-istraživačke projekte, u konsultaciji sa lokalnim i međunarodnim partnerima;</p> |
|---|---|---|

| | | |
|---|--|---|
| <p>vendorë dhe ndërkombëtarë;</p> <p>3.7. T'u japin tituj profesorëve të rregullt, të asociuar dhe personelit tjetër, në përputhje me këtë Ligj, dhe me ligjin në fuqi për punësim si dhe skemën e aprovuar nga AKA. Këto kritere përcaktohen më hollësisht me statutet e institucioneve;</p> <p>3.8. Të vendosin për mundësitë e transferimit të kredive për studentët lëvizës që vijnë apo dalin nga institucioni, duke marrë parasysh konventat aktuale për transferim të ECTS krediteve;</p> <p>3.9. Të përcaktojnë masat disiplinore për personelin akademik sipas ligjit, statutit dhe akteve të tjera të institucioneve të arsimit të lartë.</p> <p>4. Për arritjen e shkathtësive dhe njohurive praktike në kuadër të programeve specifike të studimit, institucionet e arsimit të lartë mund të themelojnë njësi të veçanta organizative apo të realizojnë ato pjesë të programeve të studimit në institucione të tjera.</p> <p>5. Institucionet publike të arsimit të lartë ruajnë neutralitetin politik dhe laicizmin, dhe brenda mjedisve të tyre nuk mund të</p> | <p>3.7. To give titles to regular professors, associate professors and other staff, in accordance with this Law and the applicable law on employment and the scheme approved by KAA. These criteria are defined in detail by the statutes of the institutions;</p> <p>3.8. To define the possibility to transfer credits for incoming and outgoing mobile students, taking into account the current conventions on the transfer of ECTS credits;</p> <p>3.9. To determine disciplinary measures for the academic staff according to the law, statute and other acts of higher education institutions.</p> <p>4. In order to achieve practical skills and knowledge within specific study programs, higher education institutions could establish particular organizational units or realize those parts of study programs in other institutions.</p> <p>5. Public institutions of higher education shall maintain the political neutrality and laicism and no political party or religious</p> | <p>3.7. Da daju zvanja redovnim profesorima, vanrednim profesorima i ostalom osoblju, u skladu sa ovim Zakonom i važećim zakonom o zapošljavanju i odobrenom šemom od strane AKA. Ovi kriterijumi su precizirani statutima institucija;</p> <p>3.8. Da definišu mogućnost transfere kredita za ulaznu i izlaznu mobilnost studenata, uzimajući u obzir trenutne konvencije o prenosu ESPB bodova;</p> <p>3.9. Da utvrde disciplinske mere za akademsko osoblje u skladu sa zakonom statutom i drugim aktima institucija visokog obrazovanja.</p> <p>4. U cilju postizanja praktičnih vještina i znanja u okviru posebnih studijskih programa, institucije visokog obrazovanja mogu da uspostave posebne organizacione jedinice ili realizuju one delove studijskih programa u drugim institucijama.</p> <p>5. Javne institucije visokog obrazovanja održavaju političku neutralnost i laicizam, i u okviru njihovih prostorija se ne mogu</p> |
|---|--|---|

| | | |
|--|---|---|
| <p>zhvillohen veprimtari partiake ose religjioze.</p> <p>6. Institucioni publik i arsimit të lartë lirohet nga të gjitha format e tatimeve për veprimtaritë e tij mësimore dhe kërkimore-shkencore, të cilat financohen nga burime publike apo të dhuruara, përveç rasteve kur merren me veprimtari fitimprurëse apo shërbyese.</p> <p>7. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara në këtë Ligj dhe në dokumentet plotësuese të nxjerra në bazë të tij, çdo institucion publik i arsimit të lartë ka gjithashtu edhe të drejtën të:</p> <p>7.1. Zotëroj dhe menaxhoj tokën, ndërtesat dhe pasuri të tjera kapitale;</p> <p>7.2. Pranoj dhe administroj fonde nga cilido lloj burimi i ligjshëm kombëtar apo i huaj, në përputhje me misionin e tij akademik dhe kushtet e përcaktuara në këtë ligj dhe çfarëdo statuti të ndërlidhur;</p> <p>7.3. Huazoj para për qëllime të duhura, brenda kufizimeve, në atë masë dhe në brenda kushteve që parashihen me rregullore financiare, të miratuara në kuadër të statudit të institucionit;</p> | <p>activities can be carried out within their environments.</p> <p>6. Public institution of higher education are released from all forms of taxes for their teaching activities and scientific research, which are financed by public and donated sources, except when they carry out commercial or service activities.</p> <p>7. With the exception of cases defined in this Law and additional documents issued under it, each public institution of higher education has also the right to:</p> <p>7.1. Own and manage land, buildings and other capital assets;</p> <p>7.2. Receive and administer funds from any kind of national or foreign legal source, in accordance with its academic mission and the conditions established within this Law and any related statutes;</p> <p>7.3. Borrow money for appropriate purposes, within limits, in that measure and within conditions that are foreseen with financial regulations, adopted within the institution's statutes;</p> | <p>razvijati političke ili verske aktivnosti.</p> <p>6. Javna institucija visokog obrazovanja se oslobađa od svih oblika poreza za njihove nastavne aktivnosti i naučna istraživanja, koja se finansiraju iz javnih ili doniranih izvora, osim kada se odvijaju komercijalne ili uslužne aktivnosti.</p> <p>7. Sa izuzetkom slučajeva utvrđenih ovim Zakonom i dodatnim dokumentima izdatim na osnovu njega, svaka javna institucija visokog obrazovanja ima i pravo da:</p> <p>7.1. Posедуje i upravlja zemljištem, zgradama i drugim osnovnim sredstvima;</p> <p>7.2. Prima i upravlja sredstvima iz bilo koje vrste domaćeg ili stranog pravnog izvora, u skladu sa svojom misijom i akademskim uslovima utvrđenim u ovom Zakonu i srodnim statutima;</p> <p>7.3 . Pozajmljuje novac za odgovarajuće svrhe, u okviru granica, u toj meri i u uslovima koji su predviđeni finansijskim propisima, usvojenim u okviru statuta institucije;</p> |
|--|---|---|

| | | |
|---|---|--|
| <p>7.4. Propozoj tek Ministri tarifat e shërbimeve dhe studimeve për aprovim të mëtejme;</p> <p>7.5. Emëroj dhe ndërpres marrëdhënien e punës së personelit akademik dhe kuadrit tjetër si dhe të ushtror të gjitha detyrat e një punëdhënësi, siç është paraparë me legjislacionin në fuqi;</p> <p>7.6. Lidh kontrata për blerjen e mallrave dhe shërbime;</p> <p>7.7. Krijoj marrëdhënie ligjore me studentët;</p> <p>7.8. Themeloj ndërmarrje komerciale për qëllime arsimore dhe hulumtuese;</p> <p>7.9. Nënshkruaj marrëveshje me institucionet e tjera në Republikën e Kosovës dhe me institucione ndërkombëtare.</p> <p>8. Me kusht të plotësimit të kërkesave sipas ligjit në fuqi, autoritetet publik përkatëse mund t'i japin një institucioni publik të arsimit të lartë, të drejtën e shfrytëzimit të truallit, ndërtesave apo pajisjeve që janë pronë publike dhe shoqërore.</p> | <p>7.4. Propose charges for service and study fees to the Minister for approval;</p> <p>7.5. Nominate and terminate the employment relationship of academic staff and other staff and perform all the duties of an employer, as provided by the applicable laws;</p> <p>7.6. Make contracts for the acquisition of goods and services;</p> <p>7.7. Create legal relationships with students;</p> <p>7.8. Establish commercial enterprises for educational and research purposes;</p> <p>7.9. Sign agreements with other institutions in the Republic of Kosova and with international institutions.</p> <p>8. On condition of meeting the requirements under the applicable law, respective public authorities may give to a public higher education institution the right to use land, buildings or equipment that are public and social property.</p> | <p>7.4. Predlaže naknade za usluge i studijske naknade ministru za odobrenje;</p> <p>7.5. Imenuje i prekida radni odnos akademskog osoblja i ostalih zaposlenih i obavlja sve poslove poslodavca, kao što je predviđeno važećim zakonima;</p> <p>7.6. Sklapa ugovore za nabavku robe i usluge;</p> <p>7.7. Uspostavlja pravne odnose sa studentima;</p> <p>7.8. Uspostavlja komercijalna preduzeća za obrazovne i istraživačke svrhe;</p> <p>7.9. Potpisuje sporazume sa drugim institucijama u Republici Kosovo i sa međunarodnim institucijama.</p> <p>8. Pod uslovom ispunjavanja uslova prema važećem zakonu, odgovarajuće javne vlasti mogu dati javnim institucijama visokog obrazovanja pravo na korišćenje zemljišta, zgrada ili opreme koja je javna i društvena svojina.</p> |
|---|---|--|

| | | |
|--|--|--|
| <p>9. Një institucion publik i arsimit të lartë, i cili shfrytëzon truallin, ndërtesat apo pajisjet që janë pronë publike ose shoqërore nuk mund ta shesë atë ose t'ia jap dikujt të drejtat pronësore të kësaj prone. Një institucion publik i arsimit të lartë, i cili ka në shfrytëzim një pronë publike ose shoqërore, mund ta japë me qira këtë pronë, sidoqoftë, me kusht që më parë të ketë marrë miratimin formal nga autoriteti publik i cili e ka dhënë në shfrytëzim këtë pronë para se të jepet prona me qira. Nëse jepet ky miratim, autoriteti publik përcakton kushtet për shfrytëzimin e të ardhurave nga kjo pronë.</p> | <p>9. A public higher education institution, which uses land, buildings or equipment that is public or social property cannot sell or give to anybody else the property rights of this property. It may however rent out this property on the condition that they receive formal approval by the public authority that has given this property for use prior to renting out the property. If such consent is granted, the public authority establishes the conditions of use of the income generated by this property.</p> | <p>9. Javne institucije visokog obrazovanja, koje koriste zemljište, zgrade ili opremu koja je javna ili društvena imovina, ne mogu da prodaju ili daju nekome drugome imovinska prava ove imovine. Mogu, međutim, iznajmiti nekretninu pod uslovom da dobiju formalno odobrenje od strane javnog organa koji je dao ovu imovinu na upotrebu pre iznajmljivanja imovine. Ako se dobije takav pristanak, javni organ utvrđuje uslove korišćenja prihoda od ove imovine.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 19 Statutet e institucioneve publike të arsimit të lartë</p> | <p style="text-align: center;">Article 19 Statutes of public higher education institutions</p> | <p style="text-align: center;">Član 19 Statuti javnih institucija visokog obrazovanja</p> |
| <p>1. Statutet e institucioneve publike të arsimit të lartë, përmbajnë normat bazë që rregullojnë veprimtarinë e tyre dhe që përfshijnë dispozita që garantojnë lirinë akademike të personelit mësimdhënës dhe të studentëve, siç përshkruhet tutje në këtë Ligj.</p> | <p>1. Statutes of public higher education institutions contain the fundamental norms that regulate their activity and include provisions that guarantee academic freedom of staff and students, as described later in this Law.</p> | <p>1. Statuti javnih institucija visokog obrazovanja sadrže osnovne norme koje regulišu njihovu aktivnost i uključuju odredbe koje garantuju akademsku slobodu osoblja i studenata, kao što je opisano kasnije u ovom Zakonu.</p> |
| <p>2. Statuti i institucionit publik të arsimit të lartë duhet të miratohet nga Senati dhe aprovohet nga Bordi dhe i dërgohet Ministrët për ta propozuar për miratim në</p> | <p>2. The statute of public higher education institution must be adopted by the Senate and approved by the Board, and then sent to the Minister, who proposes it for</p> | <p>2. Statut javne institucije visokog obrazovanja se treba odobriti od strane Senata a usvojiti od strane Odbora i dostaviti Ministru da se predlaže kod Vlade</p> |

| | | |
|--|--|---|
| <p>Qeveri i cili ratifikohen nga Kuvendi.</p> <p>3. Ndryshimet në statut hartohen dhe miratohen me të njëjtat procedura të përcaktuara në paragrafin paraprak.</p> | <p>approval in the Government, and then the statute is ratified by the Assembly.</p> <p>3. Amendments to the statute are drafted and approved under the same procedures set out in the previous paragraph.</p> | <p>za usvajanje u Skupštini.</p> <p>3. Izmene i dopune statuta su pripremljene i odobrene pod istim procedurama navedenim u prethodnom stavu.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 20</p> <p style="text-align: center;">Konferenca e rektorëve të institucioneve publike të arsimit të lartë</p> <p>1. Konferenca e rektorëve është organ kolegjal, i pavarur, i rektorëve të institucioneve publike të arsimit të lartë; kryen veprimtari të koordinimit dhe zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovë. Konferenca e Rektorëve jep rekomandime lidhur me çështje të arsimit të lartë me interes kombëtar.</p> <p>2. Konferenca e Rektorëve mban lidhje me shoqata homologe jashtë vendit për nxitjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimeve që ndihmojnë përparimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.</p> <p>3. Themelimi dhe funksionimi bazë i Konferencës së rektorëve duhet të miratohet dhe mund të mbështetet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.</p> <p>4. Konferenca e Rektorëve funksionon në</p> | <p style="text-align: center;">Article 20</p> <p style="text-align: center;">Conference of Rectors of public higher education institutions</p> <p>1. The Rectors Conference is a collegial independent body of the Rectors of public higher education institutions; it conducts activities of coordination and development of higher education in Kosova. Rectors Conference gives recommendation regarding the issues of higher education with national interest.</p> <p>2. The Rectors Conference maintains contacts with counterpart associations abroad to promote cooperation and exchanges that help the advancement of higher education and scientific research.</p> <p>3. The establishment and basic function of the rectors' conference needs to be approved and can be supported by the Government of the Republic of Kosovo.</p> <p>4. Rectors Conference functions based on</p> | <p style="text-align: center;">Član 20</p> <p style="text-align: center;">Konferencija rektora javnih institucija visokog obrazovanja</p> <p>1. Konferencija rektora je kolegijalni nezavisan organ rektora javnih institucija visokog obrazovanja; obavlja poslove koordinacije i razvoja visokog obrazovanja na Kosovu. Konferencija rektora daje preporuke u vezi sa pitanjima visokog obrazovanja od nacionalnog interesa.</p> <p>2. Konferencija rektora održava kontakte sa svojim partnerskim udruženjima u inostranstvu kako bi se unapredili saradnja i razmene koje pomažu unapređenju visokog obrazovanja i naučnog istraživanja.</p> <p>3. Uspostavljanje i osnovna funkcija konferencija rektora je podržana od strane ministra.</p> <p>4. Konferencija rektora funkcionise na</p> |

| | | |
|---|--|--|
| <p>bazë të statutit të miratuar prej dy të tretave (2/3) të anëtarëve të saj.</p> <p>KAPITULLI VI: STRUKTURA QEVERISËSE E INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË</p> <p>Neni 21 Organet kryesore të strukturës qeverisëse</p> <p>1. Struktura qeverisëse e institucionit publik të arsimit të lartë duhet të përcaktohet në statutin e tij, sipas këtij Ligji. Duhet të përfshijë këto organe kryesore si në vijim:</p> <p>1.1. Bordi, ka përgjegjësi strategjike dhe mbikëqyrëse;</p> <p>1.2. Senati, ka përgjegjësinë kryesore për vendimmarrje në çështjet akademike;</p> <p>1.3. Rektori, organ kryesor ekzekutiv dhe menaxherial dhe përfaqëson institucionin.</p> <p>2. Në statutin e tyre, institucionet mund të përvetësojnë emra më të veçantë për</p> | <p>the statute approved by two-thirds (2/3) of its members.</p> <p>CHAPTER VI: GOVERNING STRUCTURE OF PUBLIC HIGHER EDUCATION INSTITUTIONS</p> <p>Article 21 Main bodies of the governance structure</p> <p>1. The governing structure of the public institution of higher education must be defined in its statute in accordance with this Law. It must include the following main bodies:</p> <p>1.1. The Board, which has strategic and supervisory responsibilities;</p> <p>1.2. The Senate, which has main responsibility for decision making on the academic issues;</p> <p>1.3. The Rector, who is the main executive and managerial body and representative of the institution.</p> <p>2. In their statute, institutions may adopt more specific names for each of the three</p> | <p>osnovu statuta usvojenog od dve trećine (2/3) svojih članova.</p> <p>POGLAVLJE VI: VLADAJUĆA STRUKTURA JAVNIH INSTITUCIJA VISOKOG OBRAZOVANJA</p> <p>Član 21 Glavni organi strukture upravljanja</p> <p>1. Vladajuća struktura javne institucije visokog obrazovanja mora biti definisana statutom, u skladu sa ovim Zakonom. Ona mora da sadrži sledeća glavna tela:</p> <p>1.1. Odbor, koji ima strateške i nadzorne odgovornosti;</p> <p>1.2. Senat, koji ima glavnu odgovornost za donošenje odluka o akademskim pitanjima;</p> <p>1.3. Rektor, koji je glavno izvršno i rukovodeće telo i predstavnik institucije.</p> <p>2. U svom statutu, institucije mogu usvojiti više konkretnih imena za svako od tri tela,</p> |
|---|--|--|

| | | |
|--|--|--|
| <p>secilin nga tri organet, por që i nënshtrohen aprovimit nga Ministri.</p> <p>3. Institucionet publike të arsimit të lartë që nuk e kanë statusin e një Universiteti apo Kolegji Universitar mund të devijojnë nga rregullat e përcaktuara për secilin organ në tri nenet e mëposhtme, në varësi nga aprovimi i statuteve të tyre nga ana e Ministrisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 22 Bordi</p> <p>1. Bordi është organi kryesor mbikëqyrës i institucionit publik të arsimit të lartë.</p> <p>2. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Bordit janë:</p> <p>2.1. Të garantoj qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;</p> <p>2.2. Të miratoj planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe rishikon zbatimin e tij;</p> <p>2.3. Të miratoj planin financiar, buxhetin dhe llogarit vjetore të audituara të institucionit;</p> <p>2.4. Të miratoj raportin vjetor të</p> | <p>bodies, subject to approval by the Minister.</p> <p>3. Public higher education institutions that do not have the status of a University or University College may derogate to the rules set out for each body in the following three articles, subject to approval of their statutes by the Minister.</p> <p style="text-align: center;">Article 22 The Board</p> <p>1. The Board is the main supervising body of public higher education institution.</p> <p>2. Main duties and responsibilities of the Board are:</p> <p>2.1. Guarantee the fulfilment of the institution's mission and its financial sustainability;</p> <p>2.2. Approve the institution's strategic development plan and review its implementation;</p> <p>2.3. Approve the institution's financial plan, its budgets and its annual audited accounts;</p> <p>2.4. Approve the Rector's annual</p> | <p>uz saglasnost ministra.</p> <p>3. Javne institucije visokog obrazovanja koje nemaju status univerziteta ili univerzitetskog koledža mogu odstupiti od pravila koja su propisana za svako telo u sledeća tri člana, uz saglasnost njihovih statuta od strane ministra.</p> <p style="text-align: center;">Član 22 Odbor</p> <p>1. Odbor je glavni nadzorni organ javne institucije visokog obrazovanja.</p> <p>2. Glavne dužnosti i odgovornosti Odbora su:</p> <p>2.1. Garantuje ispunjenje misije institucije i njenu finansijsku održivost;</p> <p>2.2. Odobrava strateški plan razvoja institucije i preispituje njegovo sprovođenje;</p> <p>2.3. Usvaja finansijski plan institucije, njene budžete i njene godišnje revidirane račune;</p> <p>2.4. Odobrava godišnji izveštaj o</p> |
|--|--|--|

| | | |
|--|---|---|
| <p>veprimtarisë dhe performancës së institucionit, i hartuar nga Rektori dhe i a përcjell atë Ministrit;</p> <p>2.5. Të aprovoj paraprakisht statutin dhe ndryshimet e tij, para se të miratohet nga Senati;</p> <p>2.6. Të zgjedh Rektorin e institucionit nga lista e renditur e dy (2) deri në tre (3) kandidatëve të propozuar nga Senati.</p> <p>3. Bordi do të ketë numër tek të anëtarëve, jo më shumë se nëntë (9) dhe jo më pak se pesë (5) anëtarë, gjë që përcaktohet në statutet e institucioneve. Anëtarët e Bordit kanë mandat katër (4) vjeçar, dhe pas një procesi të hapur kandidimi kanë të drejtë të rizgjidhen/riemërohen edhe për një mandat. Mandati i anëtarëve të Bordit nuk duhet të fillojë në vitin e njëjtë akademik kur fillon mandati i anëtarëve të Senatit dhe Rektorit.</p> <p>4. Shumica absolute e anëtarëve të Bordit zgjidhen nga vetë institucioni. Një numër i caktuar i anëtarëve të Bordit zgjedhen me votë të drejtpërdrejtë nga stafi akademik dhe një anëtar i Bordit zgjedhet me votë të drejtpërdrejtë nga studentët, me mandat një (1) vjeçar. Një numër i anëtarëve të</p> | <p>report on activities and performance of the institution and forward it to the Minister;</p> <p>2.5. Adopt the statute of the higher education institution and changes thereto, following their approval by the Senate;</p> <p>2.6. To choose the Rector of the institutions from the ranked list of two (2) to three (3) candidates proposed by the Senate.</p> <p>3. The members of the Board will be an uneven number no larger than nine (9) and no smaller than five (5), which is defined in the statutes of the institution. Members of the Board hold a four (4) years term, and after an opened process of candidacy may be re-elected/re-appointed for another term. The mandate of members of the Board should not begin at the same academic year, when starts mandate of the Senate members and the Rector.</p> <p>4. The absolute majority of members of the Board are selected from the institution itself. A specific number of Board members are selected by direct vote from academic staff and a member of the Board is selected by direct vote from the students, with one (1) year term. A</p> | <p>aktivnostima i učinku rektora institucije i dostavlja ga ministru;</p> <p>2.5. Usvaja statut institucije visokog obrazovanja i promene istog, nakon njihovog odobrenja od strane Senata;</p> <p>2.6. Bira rektora institucija sa liste rangiranih od dva (2) do tri (3) kandidata koje je predložio Senat.</p> <p>3. Broj članova Odbora će biti neparan, veći od devet (9) i ne manji od pet (5), kao što je definisano u statutima institucije. Članovi Odbora drže mandat od četiri (4) godine mandata, nakon otvorenog procesa kandidovanja i mogu biti ponovo imenovani za još jedan mandat. Mandat članova Odbora ne treba početi u istoj akademskoj godini, kada počinje mandat članova Senata i rektora.</p> <p>4. Apsolutnu većinu članova Odbora je izabrala sama institucija. Određeni broj članova Odbora se izaberu direktnim glasanjem od akademskog osoblja a jedan član Odbora se izabere direktnim glasanjem od strane studenata sa mandatom od jedne (1) godine. Broj ovih</p> |
|--|---|---|

| | | |
|--|---|---|
| <p>zgjedhur mund të jenë nga komuniteti akademik ndërkombëtar. Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Bordit, si dhe numri i anëtarëve të zgjedhur me votë të drejtpërdrejtë nga stafi akademik dhe Senati, përcaktohen me statutin e institucionit. Nuk mund të jenë anëtarë të Bordit zyrtarët e emëruar me përgjegjësi ekzekutive në institucionin e arsimit të lartë. Zyrtarët e emëruar me përgjegjësi ekzekutive mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Bordit, pa të drejtë vote.</p> <p>5. Ministri emëron anëtarët e jashtëm të Bordit, numri i të cilëve duhet të jetë për një më i vogël sesa numri i anëtarëve të zgjedhur nga institucioni. Anëtarët e Bordit që emërohen nga Ministri duhet të jenë persona me reputacion të lartë publik dhe të arritura të veçanta në shkencë, shoqëri ose afarizëm, në nivel kombëtar apo ndërkombëtarë.</p> <p>6. Anëtar i Bordit nuk mund të jetë: personi që ka ndonjë pozitë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, dhe/ose ka statusin e zyrtarit të lartë publik në kuptim të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit mbi çfarëdo baze tjetër përveç si anëtar i Bordit të institucionit, personi aksionarë, bashkëpronarë ose i punësuar</p> | <p>number of these members may be from the international academic community. The selection procedures of members of the Board, as well as the number of members selected by direct vote from academic staff and the Senate are defined with the institution's statute. Appointed officials with executive responsibilities cannot be members of the Board at the institution of higher education. Appointed officials with executive responsibility can be invited to participate to the meetings of the Board, without the right to vote.</p> <p>5. The Minister appoints external members of the Board, whose number should be by one (1) smaller than the number of those selected by the institution. Members of the Board that are appointed by Minister should be persons with high public reputation and particular achievements in science, society or business, at national and international level.</p> <p>6. Members of the Board cannot be: a person who has a position in the Government of the Republic of Kosova and/or has the status of a senior public official within the meaning of the Law on prevention of conflict of interest on any basis other than as a member of the Board of the institution, or a person who is a</p> | <p>članova može biti iz međunarodne akademske zajednice. Procedure izbora članova Odbora, kao i broja izabranih članova direktnim glasanjem od strane akademskog osoblja i Senata su definisani statutom institucije. Imenovani zvaničnici sa izvršnim nadležnostima ne mogu biti članovi Odbora u instituciji visokog obrazovanja. Imenovani službenici sa izvršnom odgovornošću mogu biti pozvani da učestvuju na sastancima Odbora, bez prava glasa.</p> <p>5. Ministar imenuje spoljne članove Odbora, čiji broj bi trebalo da je za jedan (1) manji od broja onih koje je izabrala institucija. Članovi Odbora koje su imenovao ministar treba da budu lica sa visokim javnim ugledom i posebnim dostignućima u nauci, društvu i biznisu, na nacionalnom i međunarodnom nivou.</p> <p>6. Članovi Odbora ne mogu biti: osoba koja ima poziciju u Vladi Republike Kosovo i/ili ima status višeg javnog službenika u smislu Zakona o sprečavanju sukoba interesa po bilo kom osnovu osim kao član Odbora institucije, odnosno lice koje je vlasnik, suvlasnik ili zaposleni u nejavnim licenciranim institucijama</p> |
|--|---|---|

| | | |
|--|--|---|
| <p>në institucione jopublike të licencuara të arsimit të lartë në Kosovë, si dhe anëtarët e organeve drejtuese të institucioneve tjera të arsimit të lartë, të partive politike dhe të organizatave sindikale.</p> <p>7. Procedura e emërimit të anëtarëve të Bordit duhet të përfundojë të paktën tre (3) muaj para skadimit të mandatit të përbërjes aktuale të Bordit.</p> <p>8. Të gjithë anëtarët e Bordit shërbejnë në cilësi individuale në Bord, e jo si të deleguar ose përfaqësues të grupit me interes të veçantë.</p> <p>9. Bordi e zgjedh vetë kryesuesin nga radhët e anëtarëve të emëruar nga Ministri dhe zëvendës-kryesuesin nga radhët e anëtarëve të tjerë. Nëse kryesuesi largohet apo është nën akuzë, zëvendës-kryesuesi bëhet ushtrues detyre i kryesuesit. Nëse të dy, kryesuesi dhe zëvendës-kryesuesi, largohen apo janë nën akuza, Ministri e përcakton një ushtrues detyre të kryesuesit nga anëtarët e mbetur të bordit, për një periudhë jo më shumë se gjashtë (6) muaj. Në të dy rastet, sapo të kompletohet bordi, do të organizohen zgjedhjet e reja për kryesuesin dhe zëvendës-kryesuesin.</p> | <p>shareholder, co-owner or employee in licensed non-public institutions of higher education in Kosovo, or a member of a governing body of another higher education institutions, a political party or a union organization.</p> <p>7. The appointment of members of the Board should end at least three (3) months before mandate expiration of the current composition of the Board.</p> <p>8. All members of the Board serve in their personal capacity in the Board, and not as delegates or representatives of special interest group.</p> <p>9. The Board elects itself its Chairperson from among the members appointed by the Minister and its vice-chairperson, from among other members. If the Chairperson is dismissed or under indictment, vice-chairperson becomes acting chairperson. If both the chairperson and vice-chairperson, are dismissed or under indictment, the Minister appoints an Acting Chairperson from the remaining members of the board, for a period of not more than six (6) months. In both cases, once the board is completed, new elections will be organised for the Chairperson and Vice-Chairperson.</p> | <p>visokog obrazovanja na Kosovu, ili član upravnog tela drugih institucija visokog obrazovanja, političke stranke ili sindikalne organizacije.</p> <p>7. Imenovanje članova Odbora treba da se završi najmanje tri (3) meseca pre isteka mandata aktuelnog sastava Odbora.</p> <p>8. Svi članovi Odbora služe u ličnom svojstvu u Odboru, a ne kao delegati ili predstavnici posebne interesne grupe.</p> <p>9. Odbor sam bira predsedavajućeg iz redova članova imenovanih od strane ministra i svoga potpredsednika, iz redova svojih članova . Ukoliko predsednik da ostavku ili je pod optužbom, potpredsednik postaje vršilac dužnosti predsednika. Ukoliko oboje, predsednik i potpredsednik podnose ostavku ili su pod optužbom, ministar određuje vršioca dužnosti predsednika iz redova preostalih članova Odbora, za period ne duži od šest (6) meseci. U oba slučaja, čim se kompletira Odbor, biće organizovani novi izbori za predsednika i potpredsednika.</p> |
|--|--|---|

| | | |
|---|---|---|
| <p>10. Të gjithë anëtarët e Bordit shërbejnë me kohë të pjesshme dhe takohen tre (3) herë në semestër në mbledhje të rregullta, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme.</p> <p>11. Mandati i anëtarit të Bordit përfundon para kohe me rastin e vdekjes, dorëheqjes ose shkarkimit.</p> <p>12. Anëtarët e Bordit mund të shkarkohen nga organi që i ka emëruar apo zgjedhur për arsye bindëse si:</p> <p>12.1. Dënim për një vepër penale që ndëshkohet me burgim;</p> <p>12.2. Paaftësi në kryerjen e funksioneve të postit për shkak të paaftësisë fizike apo mendore, të dokumentuar me një raport nga së paku dy (2) mjek, të caktuar sipas legjislacionit në fuqi;</p> <p>12.3. Dështim, refuzim, shpërfillje, paaftësi të vazhdueshme për të përmbushur detyrat e postit, ose për të vepruar në përputhje me parimet e përcaktuara në statutin e institucionit apo në këtë Ligj.</p> | <p>10. All Board members serve part-time and meet three (3) times per semester in regular meetings, except in extraordinary cases.</p> <p>11. The mandate of the members of the Board ends before time in case of death, resignation or discharge.</p> <p>12. The members of the Board can be discharged by the body that has nominated or elected them for convincing reasons, such as:</p> <p>12.1. Punishment for a criminal offense, which is punishable by imprisonment;</p> <p>12.2. Incapability in performance of functions of the post due to physical or mental incapability, documented with a report from at least two (2) physicians, set according to the applicable laws;</p> <p>12.3. Failure, rejection, contempt, continuous inability to fulfil the duties of the position or to act in accordance with the principles set out in the statute of the institution or in this Law.</p> | <p>10. Svi članovi Odbora služe skraćeno radno vreme i sastaju se tri (3) puta po semestru na redovnim sastancima, osim u hitnim slučajevima.</p> <p>11. Mandat članova Odbora se završava pre vremena u slučaju smrti, ostavke ili otpuštanja.</p> <p>12. Članovi Odbora može biti otpušteni od strane organa koji ih je nominovao ili izabrao iz ubedljivih razloga, kao što su:</p> <p>12.1. Kazna za krivično delo koje je kažnjivo zatvorom;</p> <p>12.2. Nesposobnost u obavljanju funkcija nakon fizičke ili mentalne nesposobnosti, dokumentovane izveštajem od najmanje dva (2) lekara, postavljenim u skladu sa važećim zakonima;</p> <p>12.3. Neuspeh, odbacivanje, prezir, kontinuirana nemogućnost da se ispune obaveze na poziciji ili da se postupi u skladu sa principima utvrđenim statutom institucije ili u ovom Zakonu.</p> |
|---|---|---|

| | | |
|--|---|--|
| <p>13. Nismën për shkarkimin e anëtarit të Bordit mund ta jep vet Bordi me 2/3 e numrit të përgjithshëm të votave, Senati i institucionit, si dhe Ministri. Në rast të një nisme të tillë, organi që e ka zgjedhur ose emëruar anëtarin për të cilin propozohet shkarkimi, është i detyruar t'a shqyrtojë propozimin në afat prej 30 ditësh.</p> <p>14. Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit të Bordit, anëtari i ri zgjidhet apo emërohet për të zëvendësuar anëtarin që largohet, në përputhje me procedurën e përshkruar në këtë nen, për periudhën e mbetur kohore të mandatit të anëtarit që e ka përfunduar mandatin para kohe.</p> | <p>13. The initiative for discharge of a member of the Board can come from the Board itself with 2/3 of the general number of votes, the Senate of the institution or the Minister. In case of such an initiative, the body that elected or appointed member for whom discharge is proposed, is obliged to review the proposal within 30 days.</p> <p>14. In the event of early termination of the mandate of a member of the Board, a new member is elected or appointed to replace the departing member, in accordance with the procedure described in this article, for the remaining period of the mandate of the member who has not completed its mandate.</p> | <p>13. Inicijativa za otpuštanje člana Odbora može doći od samog Odbora sa 2/3 opšteg broja glasova, Senata institucije ili ministra. U slučaju ovakve inicijative, telo koje bira, odnosno imenuje člana za kojeg je predloženo otpuštanje, dužno je da razmotri predlog u roku od 30 dana.</p> <p>14. U slučaju ranog prestanka mandata člana Odbora, novi član se bira ili imenuje kao zamena za člana koji odlazi, u skladu sa procedurom koja je opisana u ovom članu, za preostali period mandata člana koji nije završio svoj mandat.</p> |
| <p>Neni 23 Senati</p> | <p>Article 23 The Senate</p> | <p>Član 23 Senat</p> |
| <p>1. Senati është organi kolegjal kryesor akademik i institucionit publik të arsimit të lartë. Senati mban përgjegjësinë kryesore për vendimmarrjen në çështjet akademike, si mësimdhënia, hulumtimi dhe publikimet.</p> <p>2. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Senatit janë:</p> | <p>1. The Senate is the main collegial academic body of a public higher education institution. The Senate holds the primary responsibility for decision-making on academic matter such as teaching, research and publications.</p> <p>2. Main duties and responsibilities of the Senate are:</p> | <p>1. Senat je glavno kolegijalno akademsko telo javne institucije visokog obrazovanja. Senat ima primarnu odgovornost za donošenje odluka o akademskim pitanjima kao što je predavanje, istraživanje i publikacije.</p> <p>2. Glavne obaveze i odgovornosti Senata su:</p> |

| | | |
|--|---|--|
| <p>2.1. Të garantojë lirinë akademike të personelit akademik, si dhe të drejtat e studentëve;</p> <p>2.2. Aprovon statutin e institucionit të arsimit të lartë pasi të jetë marrë aprovimi paraprak i Bordit;</p> <p>2.3. Të zgjedhë një numër të caktuar të anëtarëve të Bordit që propozohen nga institucioni;</p> <p>2.4. Të shpallë konkursin për Rektor, pranon aplikacionet dhe krijon për Bordin listën renditur të dy (2) deri në tre (3) kandidatëve për përzgjedhjen e Rektorit të atij institucioni;</p> <p>2.5. Të konfirmojë propozimet e njësisive akademike për zgjedhjen e dekanëve të tyre dhe të dorëzojë për aprovim te Rektori dekanët e emëruar nga Senati ;</p> <p>2.6. Të zgjedhë, rizgjedhë dhe avancojë në thirrje akademike personelin akademik të institucionit;</p> <p>2.7. Të themelojë Komisionin e Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik për dhënien e titujve akademikë, si edhe komisionet e tjera të nevojshme për funksionimin e senatit;</p> | <p>2.1.To guarantee the academic freedom of academic staff, as well as the rights of students;</p> <p>2.2.To approve the statute of the higher education institution before its adoption by the Board;</p> <p>2.3.To select specific members of the Board who are proposed by the institution;</p> <p>2.4.To announce the competition for Rector, gather applications, and establish for the Board a ranked list of two (2) to three (3) candidates for the Rector of the institutions;</p> <p>2.5. To confirm the proposals of academic units for selecting their deans and to submit the appointment of deans by the Senate to the approval of the Rector.</p> <p>2.6.To elect, re-elect and academically advance the institution's academic personnel;</p> <p>2.7.To establish a Permanent Commission for the promotion of academic staff for the granting of academic titles, as well as any other commission which is seen as useful for</p> | <p>2.1. Da garantuje , akademsku slobodu akademskog osoblja, kao i prava studenata;</p> <p>2.2.Da odobri statut institucije visokog obrazovanja pre njenog usvajanja od strane Odbora;</p> <p>2.3.Da bira članove Odbora koji su predloženi od strane institucije;</p> <p>2.4.Da objavi konkurs za rektora, prikuplja aplikacije, i da stvori za Odbor rangiranu listu od dva (2) do tri (3) kandidata za rektora institucija;</p> <p>2.5.Da potvrdi predloge akademskih jedinica za izbor njihovih izvršnih organa;</p> <p>2.6.Da izabere, ponovno izabere i akademski unapređuje akademsko osoblje institucije;</p> <p>2.7.Da uspostavi Stalnu komisiju za promociju akademskog osoblja za dodelu akademskih zvanja, kao i bilo koje druge komisije koja se smatra korisnim za rad Senata;</p> |
|--|---|--|

| | | |
|--|--|--|
| <p>2.8. Të hartojë planin strategjik për zhvillimin akademik të institucionit të arsimit të lartë në bashkëpunim me Rektorin;</p> <p>2.9. Të aprovojë hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e njësive akademike dhe programeve studimore dhe kërkimore-shkencore në përputhje me planin strategjik dhe buxhetin e institucionit.</p> <p>2.10. Të aprovojë planin vjetor të aktiviteteve akademike dhe kërkimore-shkencore/ artistike;</p> <p>2.11. Të propozojë kriteret dhe procedurat për pranimin dhe regjistrimin e studentëve, në përputhje me Ligjin dhe aktet e brendshme të institucionit;</p> <p>2.12. Të vendosë për procedurën disiplinore ndaj studentëve dhe mësimdhënësve;</p> <p>2.13. Të zgjedhë kryesuesin e Senatit nga radhët e anëtarëve të vetë;</p> <p>2.14. Të shqyrtojë çështjet e tjera akademike me kërkesë të Bordit apo</p> | <p>the work of the Senate;</p> <p>2.8. To prepare the strategic plan of the academic development of the higher education institution, together with the Rector.</p> <p>2.9. To approve the opening, reorganization and closure of academic units and of study and scientific research programs, in line with institution's strategic plan and its budget;</p> <p>2.10. To approve the annual plan of academic and research-scientific/artistic activities;</p> <p>2.11. To determine the criteria and procedures for the acceptance and enrolment of students, in accordance with the Law and internal acts of the institution;</p> <p>2.12. To decide on disciplinary proceedings against students and teachers;</p> <p>2.13. To elect the Chairperson of the Senate from among its members;</p> <p>2.14. To examine any other academic issue upon the request of the</p> | <p>2.8. Da priprema strateški plan akademskog razvoja Institucije visokog obrazovanja, zajedno sa rektorom.</p> <p>2.9. Da odobri otvaranje, reorganizovanje i zatvaranje akademskih jedinica i studijskih i naučno-istraživačkih programa, u skladu sa strateškim planom institucije i njenim budžetom;</p> <p>2.10. Da odobri godišnji plan akademskih i naučno-istraživačkih/umetničkih aktivnosti;</p> <p>2.11. Da utvrdi kriterijume i postupke za prijem i upis studenata u skladu sa Zakonom i internim aktima institucije;</p> <p>2.12. Da odlučuje o disciplinskim postupcima protiv studenata i nastavnika;</p> <p>2.13. Da izabere predsedavajućeg Senata iz redova svojih članova;</p> <p>2.14. Da razmatra bilo koje drugo akademsko pitanje na zahtev Odbora</p> |
|--|--|--|

| | | |
|--|--|--|
| <p>Rektorit;</p> <p>3. Funkcionet të tjera të Senatit përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë.</p> <p>4. Anëtarët e Senatit zgjidhen nga radha e personelit akademik, personelit jo akademik dhe studentëve. Nuk mund të jenë anëtarë të Senatit, zyrtarët ekzekutiv të emëruar brenda institucionit: Rektori, Prorektorët, Dekanët, Prodekanët dhe personat tjerë që mbajnë poste ekzekutive. Të paktën 15% e anëtarëve të Senatit me të drejtë vote duhet të jenë nga radhët e studentëve.</p> <p>5. Të paktën gjysma e anëtarëve të Senatit nga personeli akademik duhet të jenë profesorë të rregullt. Në mungesë të kandidatëve me tituj të profesorit të rregullt, kandidatët mund të zgjidhen edhe nga personeli akademik me titullin më të lartë akademik në njësitë akademike përkatëse. Gjysma tjetër e Senatit zgjedhet nga radhët e profesorëve të asociuar dhe profesorëve asistentë dhe asistentëve.</p> <p>6. Mandati i anëtarëve akademikë dhe jo akademikë të Senatit është katër (4) vite. Mandati i anëtarëve nga radha e studentëve është një (1) vit, pa të drejtë të</p> | <p>Board or the Rector;</p> <p>3. Other functions of the Senate are determined by the statute of the higher education institution.</p> <p>4. Senate members are elected from among the academic staff; the non-academic staff and students. Rector, Vice-Rectors, Deans and other staff that holds executive positions within the institution cannot be members of the Senate. At least 15% of the Senate members with voting right must be from students.</p> <p>5. At least half of the members of the Senate from academic staff must be regular professors. In the absence of candidates with the title of regular professors, candidates may also be selected from the academic staff with the highest academic title in the respective academic units. The other half of the Senate is elected from the ranks of associate professors and assistant professors and assistants.</p> <p>6. The mandate of academic and non-academic members of the Senate is four (4) years. The mandate of student members shall be one (1) year, without</p> | <p>ili rektora;</p> <p>3. Ostale funkcije Senata su utvrđene statutom institucije visokog obrazovanja.</p> <p>4. Članovi Senata se biraju iz redova akademskog osoblja, ne-akademskog osoblja i studenata. Rektor, prorektori, dekani, i ostalo osoblje koje nosi izvršne pozicije unutar institucije ne mogu biti članovi senata. Najmanje 15% članova Senata sa pravom glasa treba da budu iz redova studenata.</p> <p>5. Najmanje polovina članova Senata iz akademskog osoblja treba da budu redovni profesori. U odsustvu kandidata sa zvanjem redovnog profesora, kandidati takođe mogu biti izabrani iz akademskog osoblja sa najvišim zvanjem u odgovarajućim akademskim jedinicama. Druga polovina Senata se bira iz redova vanrednih profesora i asistenata profesora i asistenata.</p> <p>6. Mandat akademskih i ne-akademskih članova Senata je četiri (4) godine. Mandat članova iz redova studenata je jedna (1) godina, bez prava na ponovno biranje.</p> |
|--|--|--|

| | | |
|---|---|---|
| <p>rizgjedhjes. Mandati i anëtarëve të Senatit fillon me vitin e ri akademik.</p> <p>7. Numri dhe mënyra e zgjedhjes, shkarkimit dhe zëvendësimit të anëtarëve të Senatit të cilëve u ka pushuar mandati rregullohet me statutin e institucionit.</p> <p>8. Senati mbledhet periodikisht dhe mund të marrë vendime në mbledhje ku marrin pjesë më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Senatit me të drejtë vote. Vendimi merret me shumicë të votave të anëtarëve të pranishëm me të drejtë vote.</p> <p>9. Për çështjet që kanë të bëjnë me ndryshimet e statutit, zgjedhjen e organeve të institucionit, komisioneve të Senatit dhe zgjedhjen dhe avancimin e personelit akademik, shkarkimin e anëtarëve të Bordit, nismën për shkarkimin e Rektorit, Prorektorëve, Dekanëve apo Prodekanëve, Senati mund të vendos nëse në seancë marrin pjesë së paku 2/3 nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Senatit me të drejtë vote, ndërsa merr vendim me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm.</p> | <p>the right to re-election. The mandate of the members of the Senate begins in the new academic year.</p> <p>7. The number and method of elections, dismissals and replacements of members of the Senate whose mandate was terminated is regulated by the statute of the institution.</p> <p>8. The Senate meets regularly as needed and can make decisions in sessions attended by more than half of the total number of Senate members with the right to vote. The decision shall be taken by majority votes of the members present who have the right of voting.</p> <p>9. For matters relating to amendments of the statutes, the election of institutional authorities, senate committees and election or advancement of academic personnel, dismissal of board members, initiatives for dismissal of the Rector, Pro-Rectors, Deans and Vice-Deans, the Senate can decide if the session is attended at least 2/3 of the total number of members of the Senate, and decides by a simple majority of members present.</p> | <p>Mandat članova Senata počinje novom akademskog godinom.</p> <p>7. Broj i način biranja, razrešavanja i izmene članova senata kojima je prestao mandat se reguliše statutom institucije.</p> <p>8. Senat se sastaje redovno i po potrebi i može donositi odluke u sednicama kojima prisustvuje više od polovine ukupnog broja članova Senata sa pravom glasa. Odluka se donosi većinom glasova prisutnih članova koji imaju pravo glasanja.</p> <p>9. Za pitanja koja se odnose na izmene statuta, biranje organa institucije, komisija senata i biranje i unapređenje akademskog osoblja, razrešavanje članova odbora, inicijative za razrešavanje rektora, prorektora, dekana ili prodekana, Senat može da odluči ukoliko na sednici učestvuje najmanje 2/3 ukupnog broja članova senata sa pravom glasa, i odlučuje prostom većinom prisutnih članova.</p> |
|---|---|---|

| <p style="text-align: center;">Neni 24 Rektori</p> | <p style="text-align: center;">Article 24 The Rector</p> | <p style="text-align: center;">Član 24 Rektor</p> |
|--|--|---|
| <p>për performancën vjetore, gjendjen financiare të institucionit, parashikimin mbi angazhimin e personelit akademik, si dhe elementë të tjerë të përcaktuar me udhëzim të Ministrit. Koha e këtij raportimi është jo më vonë se më 31 mars të vitit pasues.</p> <p>3. Raporti i performancës do të krahasojë rezultatet e arritura me planin strategjik të zhvillimit dhe marrëveshjet për performancë për vitin në shqyrtim.</p> <p>4. Rektori i një institucioni publik të arsimit të lartë do t'ia tërheqë vërejtjen Bordit për çdo veprim apo lëshim të tij, i cili sipas mendimit të Rektori, përbën një shpërdorim të fondeve publike që i janë dhënë institucionit.</p> <p>5. Në rast se Bordi nuk vepron për të korrigjuar veprime të tilla jo të duhura apo lëshime, atëherë Rektori do t'ia raportojë drejtpërdrejt këto veprime ose lëshime Ministrit. Në raste të tilla, pavarësisht nga ndonjë dispozitë e statutit të institucionit që është e kundërt me këtë, Bordi apo ndonjë organ tjetër nuk mund të ndër marrë asnjë veprim ndaj Rektorit, me përjashtim të rasteve kur vetë Ministri e lejon një veprim të tillë.</p> | <p>activities carried out, the annual performance, financial condition of the institution, the forecast on the engagement of academic personnel and other elements stipulated in the instruction of the Minister. This report should be submitted no later than March 31 of the following year.</p> <p>3. The performance report will compare the achieved results with the strategic development plan and performance agreements for the year in review.</p> <p>4. The Rector of a public higher education institution will warn the Board of any action or its omission, which according to the opinion of the Rector constitutes a misuse of public funds given to the institution.</p> <p>5. In the event when the Board does not act to correct such inappropriate actions or omissions, the Rector will report directly to the Minister for such acts or omissions. In such cases, regardless by any provision of the institution's statute, which is opposite with this, the Board or any other body cannot take any action against the Rector, except in cases when the Minister itself allows such an action.</p> | <p>aktivnostima, godišnji učinak, finansijsko stanje institucije, predviđanja o angažovanju akademskog osoblja i drugih elemenata koji su navedeni u uputstvu ministra. Ovaj izveštaj treba dostaviti najkasnije do 31. marta naredne godine.</p> <p>3. Izveštaj učinka će uporediti postignute rezultate sa strateškim planom razvoja i sporazumima o učinku za godinu razmatranja.</p> <p>4. Rektor jedne javne institucije visokog obrazovanja će upozoriti Odboru za svaku radnju ili propust, koji, prema mišljenju Rektora, predstavlja zloupotrebu javnih sredstava koji su dati instituciji.</p> <p>5. U slučaju da Odbor ne deluje radi otklanjanja takvih neodgovarajućih radnji ili propusta, onda će rektor direktno izveštavati ministru za takve radnje ili propuste. U takvim slučajevima, bez obzira na neku odredbu statuta institucije koja je u suprotnosti sa time, Odbor ili bilo koji drugi organ ne može da preduzme nikakve radnje prema Rektoru, osim u slučaju kada sam ministar dozvoljava takvu radnju.</p> |
|---|--|---|

| | | |
|---|--|---|
| <p>6. Nëse, sipas vlerësimit të Ministrit që bazohet në raportet përfundimtare dhe rekomandimet nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, çështjet financiare apo çështjet e tjera të një institucioni kanë qenë ose janë duke u keqadministruar apo dispozitat e statutit nuk janë zbatuar në përputhje me këtë Ligj dhe me statutin, Ministri mund të jep udhëzime në lidhje me qeverisjen dhe menaxhimin e institucionit që i sheh të arsyeshme, duke përfshirë, shkarkimin dhe zëvendësimin e përkohshëm të një ose më shumë anëtarëve të Bordit ose Rektorit. Të gjitha veprimet e tilla ratifikohen nga Kuvendi brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh.</p> | <p>6. If, as estimated by the Minister which is based on final reports and recommendations from the Office of the General Auditor, financial issues or other issues of an institution have been or are being mismanaged or statutory provisions have not been implemented in accordance with this Law and statute, the Minister can give guidance regarding to governance and management of the institution that Minister sees as reasonable, by including, discharge and temporary replacement of one or more members of the Board or the Rector. All such decisions are ratified by the Assembly within sixty (60) days.</p> | <p>6. Ukoliko su, prema proceni ministra koja se zasniva na konačnim izveštajima i preporukama iz kancelarije Generalnog revizora, finansijska pitanja ili druga pitanja jedne institucije bile ili se loše upravljaju ili odredbe statuta nisu sprovedene u skladu sa ovim Zakonom ili statutom, ministar može da daje instrukcije u vezi sa upravljanjem i rukovodstvom institucije koje ministar smatra prikladnim, uključivanjem, privremenim razrešenjem ili zamenom jednog ili više članova Odbora ili Rektora. Sve slične radnje se ratifikuju od strane Skupštine u roku od šezdeset (60) dana.</p> |
| <p>KAPITULLI XI: INSTITUCIONET JOPUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË</p> | <p>CHAPTER XI: NON-PUBLIC HIGHER EDUCATION INSTITUTIONS</p> | <p>POGLAVLJE XI: NEJAVNE INSTITUCIJE VISOKOG OBRAZOVANJA</p> |
| <p>Neni 45 Organizimi dhe funksionimi</p> | <p>Article 45 Organisation and functioning</p> | <p>Član 45 Organizovanje i funkcionisanje</p> |
| <p>1. Një institucion jopublik i arsimit të lartë gëzon lirinë që në statutin e tij apo në dokumente të tjera themeluese të aprovojë çfarëdo modeli të qeverisjes dhe të menaxhimit, me kusht që ky model të ndajë në mënyrë të qartë rolin dhe kompetencat e pronarëve nga çështjet akademike.</p> | <p>1. A non-public institution of higher education enjoys freedom in its statute or in other founding documents to adopt any governance and management model, on condition that this model clearly separates the role and competencies of owners from academic matters.</p> | <p>1. Jedna nejavna institucija visokog obrazovanja uživa slobodu da na njenom statutu ili drugim osnivačkim dokumentima usvoji bilo koji model upravljanja i rukovođenja, pod uslovom da ovaj model na jasan način podeli ulogu i nadležnosti vlasnika od akademskih pitanja.</p> |

| | | |
|---|---|--|
| <p>2. Të gjitha institucionet jopublike të arsimit të lartë duhet të jenë të akredituara nga AKA dhe licencuar nga Ministri para fillimit të funksionimit të tyre. Për këtë qëllim ata duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat për akreditim dhe licencim siç përcaktohen në këtë Ligj, si dhe ato specifike si në vijim:</p> <p>2. 1. Statutet duhet të:</p> <p>2.1.1. Përcaktojnë strukturën e qeverisjes dhe menaxhimit të institucionit, së bashku me misionin dhe qëllimet e tyre strategjike dhe statutet e tyre të cilat e përcaktojnë nëse ato janë subjekte fitimprurës apo jofitimprurës;</p> <p>2.1.2. Lejojnë pjesëmarrjen e personelit mësimdhënës dhe të studentëve në vendimmarrje lidhur me çështjet akademike;</p> <p>2.1.3. I garantojnë personelit lirinë e organizimit dhe të grumbullimit dhe mbrojtjen e personelit nga çdo lloj diskriminimi;</p> <p>2.1.4 Parashih punësimin, organizimin dhe promovimin e personelit akademik, duke përfshirë</p> | <p>2. All non-public higher education institutions must be accredited by KAA and licensed by the Minister before they can start operating. For this purpose, they must meet all general conditions for accreditation and licensing set out in this Law, as well as the following specific ones:</p> <p>2.1. The statutes must:</p> <p>2.1.1. Determine the structure of governance and management of the institution, along with its mission and strategic goals and its status as a for-profit or not-for-profit entity;</p> <p>2.1.2. Allow for the participation of teaching staff and students in decision making regarding academic issues;</p> <p>2.1.3. Guarantee to personnel the freedom of organization and gathering and the protection against any kind of discrimination;</p> <p>2.1.4. Provide for the hiring, organisation and promotion of academic staff, including with</p> | <p>2. Sve privatne obrazovne institucije moraju biti akreditovane od strane AKA i licencirane od strane ministra pre nego što one mogu da počnu da rade. U tu svrhu, moraju ispunjavati sve opšte uslove za akreditaciju i licenciranje određene u ovom zakonu, kao i sledeće posebne uslove:</p> <p>2.1. Statuti moraju da:</p> <p>2.1.1. Odrede strukturu upravljanja i rukovođenja institucije, zajedno sa njenom misijom i njenim strateškim ciljevima i njenim statutsom profitabilnog ili neprofitabilnog subjekta;</p> <p>2.1.2. Dozvole učešće nastavnog osoblja i studenata u donošenju odluka u vezi sa akademskim pitanjima;</p> <p>2.1.3. Garantuju osoblju slobodu organizovanja i prikupljanja i zaštitu protiv bilo kakve diskriminacije;</p> <p>2.1.4. Obezbede zapošljavanje, organizovanje i promociju akademskog osoblja, uključujući u</p> |
|---|---|--|

| | | |
|---|---|--|
| <p>edhe dhënien e titujve akademikë dhe njohjen e kualifikimeve të huaja;</p> <p>2.2. Objektet dhe burimet e tjera fizike duhet të jenë të përshtatshme dhe të sigurta për punën arsimore të institucionit, ku institucioni ka të drejtë të plotë ligjore në shfrytëzimin e tyre;</p> <p>2.3. Mësimdhënësit, hulumtuesit dhe personeli ndihmës duhet të jenë të kualifikuar në nivelin e duhur për punën arsimore të institucionit të arsimit të lartë dhe duhet të kontraktohen ligjërisht nga institucioni;</p> <p>2.4. Institucioni duhet të ketë një sistem të mirëfilltë të auditimit financiar;</p> <p>2.5. Institucioni duhet të garantojë interesat e studentëve në rast të mbylljes, falimentimit ose humbjes së akreditimit ose licencës, siç përcaktohet në nenin 48 të këtij Ligji.</p> | <p>respect to the award of academic titles and the recognition of foreign qualifications;</p> <p>2.2. Facilities and other physical resources must be appropriate and safe to the institution's educational work, and for which the institution has full legal title to use them;</p> <p>2.3. Teachers, scientific researchers and support staff must be qualified at the appropriate level for the educational work of the higher education institution and must be legally contracted by the institution;</p> <p>2.4. The institution must have a sound financial auditing systems;</p> <p>2.5. The institution must guarantee the students' interest in case of closure, bankruptcy or loss of accreditation or licence, as set out in Article 48 of this Law.</p> | <p>odnosu na dodelu akademskih titula i priznavanje stranih kvalifikacija;</p> <p>2.2. Objekti i drugi fizički resursi moraju da budu odgovarajući i bezbedni za obrazovni rad institucije, a za koje institucija ima puni pravni naziv da ih koristi;</p> <p>2.3. Nastavnici, naučni istraživači i pomoćno osoblje moraju biti kvalifikovani u odgovarajućem nivou za obrazovni rad u instituciji visokog obrazovanja i moraju biti zakonski ugovoreni od strane institucije;</p> <p>2.4. Institucija mora imati jedan zdrav sistem finansijske revizije;</p> <p>2.5. Institucija mora da garantuje interese studenata u slučaju zatvaranja, stečaja ili gubitka akreditacije ili licence, kao što je navedeno u članu 48. ovog Zakona.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 46 Kualifikimet dhe titujt akademikë</p> | <p style="text-align: center;">Article 46 Academic qualifications and titles</p> | <p style="text-align: center;">Član 46 Akaderske kvalifikacije i zvanja</p> |
| <p>1. Titujt e Profesorit Asistent dhe më lartë mund të jepet nga një institucion jopublik i arsimit të lartë vetëm për personat që</p> | <p>1. The titles of assistant professor and above can only be given by a non-public higher education institution to persons</p> | <p>1. Zvanja asistenta profesora i više može se dati od strane nejavne institucije visokog obrazovanja licima koja</p> |

| | | |
|--|---|---|
| <p>plotësojnë të njëjtat kushte si në institucionet publike.</p> <p>2. Titujt akademikë që jepen nga institucionet jopublike të arsimit të lartë nuk janë detyruese për palët e treta.</p> <p>3. Asnjë anëtar i personelit akademik nuk mund të punësohet nga institucioni jopublik i arsimit të lartë në Kosovë, pa njohjen e mësimit paraprak/barasvlerës formale të diplomave dhe gradave të tyre të fituara jashtë Republikës së Kosovës, përveç për realizimin e programeve të studimeve të akredituara nga një autoritet jashtë Kosovës, i njohur nga AKA.</p> | <p>who meet the same conditions as at public institutions.</p> <p>2. Academic titles awarded by non-public higher education institutions are not binding for third parties.</p> <p>3. No academic staff can be hired by any non-public institution of higher education in Kosova without formal prior recognition/ equivalence of their diplomas and degrees obtained outside the Republic of Kosova, except for the realization of study programmes accredited by an authority outside of Kosovo, recognized by KAA.</p> | <p>ispunjavaju iste uslove kao u javnim institucijama.</p> <p>2. Akademska zvanja dodeljena od strane nejavne institucije visokog obrazovanja nisu obavezujuće za treće strane.</p> <p>3. Nijedno akademsko osoblje ne može biti zaposleno od strane bilo koje nejavne institucije visokog obrazovanja na Kosovu bez prethodnog formalnog priznanja/ekvivalencije njihovih titula dobijenih van Republike Kosova, osim za realizaciju programa akreditovanih studija od strane jednog autoriteta izvan Kosova, koji je priznat od strane AKA-a.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 47 Financimi</p> | <p style="text-align: center;">Article 47 Financing</p> | <p style="text-align: center;">Član 47 Financiranje</p> |
| <p>1. Institucionet jopublike të arsimit të lartë janë përgjegjëse për financimin e tyre dhe duhet të ofrojnë dëshmi për qëndrueshmërinë e tyre financiare para se të mund të licencohen.</p> <p>2. Një institucion jopublik i arsimit të lartë, i akredituar dhe licencuar, mund të marrë fonde nga Ministria për aktivitete të caktuara. Ata gjithashtu mund të marrin pjesë në thirrjet për propozime në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor të shpallura</p> | <p>1. Non-public higher education institutions are responsible for their own funding and must provide evidence of their financial stability before they may be licensed.</p> <p>2. A non-public institution of higher education, accredited and licensed, may receive funds from the Ministry for specified activities. They may also participate in calls for proposals in higher education and research issued by the</p> | <p>1. Nejavne institucije visokog obrazovanja su odgovorne za svoje finansiranje, i mora da dostave dokaze o njihovom finansijskom stabilnošću pre nego što budu licensirane.</p> <p>2. Jedna nejavna institucija visokog obrazovanja, akreditovana i licencirana može primiti sredstva od strane Ministarstva za određene aktivnosti. Oni takođe mogu učestvovati u pozivima za podnošenje priedloga u visokom</p> |

| | | |
|---|---|---|
| <p>nga Ministria apo ndonjë organ tjetër publik në Kosovë ose nga organizatat ndërkombëtare.</p> <p>3. Bordi ose organi ekuivalent i një institucioni jopublik të arsimit të lartë është kolektivisht përgjegjës para Ministrit për përdorimin e duhur dhe efektiv të fondeve që janë caktuar institucionit nga Ministria ose nga burime të tjera publike.</p> | <p>Ministry or other public body in Kosova or by international organisations.</p> <p>3. The Board or equivalent body of a non-public institution of higher education is collectively responsible before the Minister for the proper and effective use of funds that are assigned to the institution by the Ministry or by other public resources.</p> | <p>obrazovanju i istraživanju koje je izdalo Ministarstvo ili drugi javni organ na Kosovu ili od strane međunarodnih organizacija.</p> <p>3. Odbor ili ekvivalentni organ privatne institucije visokog obrazovanja je kolektivno odgovoran pred Ministrom za pravilno i efikasno korišćenje sredstava koja se dodeljuju instituciji od strane Ministarstva ili drugih javnih izvora.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 48 Garantimi i interesave të studentëve</p> | <p style="text-align: center;">Article 48 Guarantee of students' interests</p> | <p style="text-align: center;">Član 48 Garantovanje interesa studenata</p> |
| <p>1. Institucionet jopublike duhet të garantojnë interesat e studentëve në rast të mbylljes, falimentimit ose humbjes së akreditimit ose licencës, si më poshtë:</p> <p>1.1. Prezantimi i garantimit të stabilitetit financiar për së paku një (1) vit, i lëshuar nga institucioni përkatës; shuma e pasurive të institucionit të arsimit të lartë duhet të jetë së paku e barabartë me 50% të tarifës së studimit, që paguhet nga të gjithë studentët e regjistruar në vitin përkatës akademik; natyra dhe shuma e garancisë financiare për studentët mund të shpjegohet në detaje të mëtejme dhe me një akt nënligjor të lëshuar nga Ministri;</p> | <p>1. Non-public institutions must provide the following guarantees of students' interest in case of closure, bankruptcy or loss of accreditation or licence:</p> <p>1.1. Presentation of a guarantee of financial stability for at least one (1) year issued by the respective institution; the amount of assets of the higher education institution must be at least equal to 50% of the study fee paid by all students enrolled in the corresponding academic year; the nature and amount of the financial guarantee for students may be further explained in details in a sub-legal act issued by the Minister;</p> | <p>1. Privatne institucije moraju pružati sledeće garancije za interese studenata u slučaju zatvaranja, stečaja ili gubitka akreditacije ili licence:</p> <p>1.1. Predstavljanje garancije o finansijskoj stabilnosti za najmanje jednu (1) godinu, izdato od strane relevantne institucije; iznos sredstava institucije visokog obrazovanja mora biti najmanje jednak 50% tarife za studije koju plaćaju svi studenti koji su upisani u odgovarajuću akademsku godinu; priroda i iznos finansijske garancije za studente može se dalje objasniti detaljnije i jednim podzakonskim aktom izdatom od</p> |

| | | |
|---|---|--|
| <p>1.2. Marrëveshjet me së paku dy (2) institucione të tjera të akredituara të arsimit të lartë, duke siguruar që studentët mund të transferohen në programe të ngjashme në një nga këto institucione të akredituara, në rast të mbylljes, falimentimit apo tërheqjes së akreditimit; AKA dhe Ministri duhet të japin pëlqimin për marrëveshjet e arritura. Në rast të transferimit, institucioni nikoqir duhet të garantojë pranimin dhe studimin me ritme të njëjta si institucioni që është e mbyllur, ka falimentuar apo është privuar nga licenca.</p> <p>2. Një institucion jopublik i arsimit të lartë mund të mbyllet nga Bordi ose ndonjë organ tjetër ekuivalent, por vetëm në fund të vitit akademik, me qëllim që t'i mundësohet studentëve përfundimi i provimeve.</p> <p>3. Një institucion jopublik i arsimit të lartë mund të mbyllet nëse është tërhequr apo nuk rinovohet akreditimi nga AKA apo nëse i është tërhequr licenca e institucionit nga Ministri.</p> <p>4. Pavarësisht nga arsyeja e mbylljes, institucioni është i detyruar të përgatisë një</p> | <p>1.2. Agreements with at least two (2) other accredited institutions of higher education ensuring that students can be transferred to similar programs at one of these accredited institutions, in case of closure, bankruptcy or withdrawal of accreditation; KAA and the Minister must give consent for the reached agreements. In case of transfer, the host institution should guarantee the acceptance and study with same rates as the institution that is closed, bankrupt or deprived of license.</p> <p>2. A non-public institution of higher education may be closed by the Board or any equivalent body, but only at the end of an academic year, in order to enable students to complete examinations.</p> <p>3. A non-public institution of higher education may be closed if the accreditation by KAA is withdrawn or not renewed or if the institution's license by the Minister is withdrawn.</p> <p>4. Irrespective of the reason of closure, the institution is obliged to prepare a detailed</p> | <p>strane Ministra;</p> <p>1.2. Sporazumi sa najmanje dve (2) druge akreditovane institucije visokog obrazovanja koji osiguraju da se prelazak studenata na slične programe u jednoj od ovih akreditovanih institucija, u slučaju zatvaranja, stečaja ili povlačenja akreditacije; AKA i ministar moraju dati saglasnost za postignute sporazume. U slučaju prelaska, institucija domaćin bi trebalo da garantuje prihvatanje i studije sa istim stopama kao institucija koja je zatvorena, u stečaju ili je lišena licence.</p> <p>2. Privatna institucija visokog obrazovanja može biti zatvoren od strane odbora ili bilo kojeg ekvivalentnog tela, ali samo na kraju akademske godine, kako bi se omogućilo studentima da završe ispite.</p> <p>3. Privatna institucija visokog obrazovanja može da se zatvori ako je akreditacija od strane AKA povučena ili se ne obnavlja ili ako se povlači licenca institucije od strane ministra.</p> <p>4. Bez obzira na razlog zatvaranja, institucija je dužna da pripremi detaljan</p> |
|---|---|--|

| | | |
|--|--|---|
| <p>raport të detajuar për Ministrinë dhe të dërgojnë pasqyrat e notave për çdo student. Dokumentet duhet të lëshohen nga institucioni dhe dorëzohen në Ministri brenda 30 ditëve nga data e vendimit për mbyllje.</p> <p>KAPITULLI XII: DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE</p> <p>Neni 49 Akademia e Kosovës për Siguri Publike</p> <p>1. Akademia e Kosovës për Siguri Publike, e themeluar me Ligjin nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 26, 25 nëntor 2011) është institucion përgjegjës për ofrimin e arsimit të lartë për të gjitha institucionet e sigurisë publike por duke mos u kufizuar vetëm në to.</p> <p>2. Dispozitat e këtij Ligji zbatohen përshtatshëm për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, me përjashtimet e përcaktuara në Ligjin për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.</p> | <p>report for the Ministry and to send the overview of grades for each student. The documents must be issued by the institution and submitted to the Ministry within 30 days from the date of the decision for closure.</p> <p>CHAPTER XII: TRANSITIONAL AND FINAL PROVISIONS</p> <p>Article 49 Kosova Academy for Public Safety</p> <p>1. Kosova Academy for Public Safety, established by the Law no. 04 / L-053 on Kosova Academy for Public Safety (Official Gazette of the Republic of Kosova, No. 26, 25 November 2011) is an institution responsible for providing higher education to but not being limited to all public security institutions.</p> <p>2. The provisions of this Law shall apply accordingly to the Kosova Academy for Public Safety, with the exceptions set out in the Law on Kosova Academy for Public Safety.</p> | <p>izveštaj za ministarstvo i pošalje pregled ocena za svakog studenta. Dokumenti mora biti izdati od strane institucije i dostaviti ministarstvu u roku od 30 dana od dana donošenja odluke za zatvaranje.</p> <p>POGLAVLJE XII: PRELAZNE I ZAVRŠNE ODREDBE</p> <p>Član 49 Kosovska akademija za javnu bezbednost</p> <p>1. Kosovska akademija za javnu bezbednost, osnovana je Zakonom br. 04/L-053 o Kosovskoj akademiji za javnu bezbednost (Službeni list Republike Kosova, br. 26, 25. novembar 2011) je institucija koja je odgovorna za pružanje visokog obrazovanja, ali ne ograničavajući se na sve institucije javne bezbednosti.</p> <p>2. Odredbe ovog Zakona shodno će se primeniti za Kosovsku akademiju za javnu bezbednost, sa izuzecima utvrđenim u Zakonu o Kosovskoj akademiji za javnu bezbednost.</p> |
|--|--|---|

| | | |
|---|---|--|
| <p>3. Arsimi i lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike zhvillohet në përputhje me rregullat dhe procedurat përkatëse për akreditim sipas këtij Ligji.</p> <p>4. Zhvillimi i arsimit të lartë në Akademi, rregullohen me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria pas propozimit të Ministrit dhe Ministrit të Ministrisë për Punë të Brendshme.</p> | <p>3. Higher Education at the Kosova Academy for Public Safety is conducted in accordance with relevant rules and procedures of accreditation according to this Law.</p> <p>4. Development of higher education in the Academy is regulated by sub-legal act approved by the Government upon the proposal of the Minister and the Minister of the Ministry of Internal Affairs.</p> | <p>3. Visoko obrazovanje u Kosovskoj akademiji za javnu bezbednost se sprovodi u skladu sa odgovarajućim pravilima i procedurama za akreditaciju prema ovom važećem Zakonu.</p> <p>4. Razvoj visokog obrazovanja u Akademiji je regulisano podzakonskim aktom usvojenim od strane Vlade na predlog ministra i ministra Ministarstva unutrašnjih poslova.</p> |
| <p>Neni 50 Universiteti i Mitrovicës Veriore</p> | <p>Article 50 University of North Mitrovica</p> | <p>Član 50 Univerzitet u Severnoj Mitrovici</p> |
| <p>1. Universiteti i Mitrovicës Veriore është institucion publik autonom i arsimit të lartë i themeluar sipas Ligjit nr. 03/068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 30, 15 qershor 2008) dhe Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28, 4 qershor 2008).</p> <p>2. Universiteti miraton statutin që paraqet organizimin dhe qeverisjen e brendshëm të tij si dhe procedurat dhe ndërveprimin me autoritetet publike, në pajtim me kornizën ligjore qendror të Republikës së Kosovës, i cili do të shqyrtohet nga një komision i</p> | <p>1. University of North Mitrovica is an autonomous public higher education institution established under Law no. 03/068 on Education in Municipalities of the Republic of Kosova (Official Gazette of the Republic of Kosova, no. 30, 15 June 2008) and Law no. 03 / L-040 on Local Self-Government (Official Gazette of the Republic of Kosova, no. 28, 4 June 2008).</p> <p>2. University adopts a statute which presents its organization and internal governance as well as the procedures and interaction with public authorities, in accordance with central legislation framework of the Republic of Kosova,</p> | <p>1. Univerzitet u Severnoj Mitrovici je autonomna javna institucija visokog obrazovanja osnovana prema zakonu br. 03/068 o obrazovanju u opštinama Republike Kosova (Službeni list Republike Kosova, br. 30, 15. jun 2008), zakonu br. 03/L-040 o Lokalnoj samoupravi (Službeni list Republike Kosova, br. 28, 4. jun 2008).</p> <p>2. Univerzitet usvaja statut koji predstavlja svoju organizaciju i unutrašnju upravu, kao i procedure i interakciju sa javnim vlastima, u skladu sa centralnim zakonodavnim okvirom Republike Kosova, koji će biti razmatran od strane</p> |

| | | |
|---|--|--|
| <p>pavarur.</p> <p>3. Zhvillimi i arsimit të lartë në Universitetin e Mitrovicës Veriore rregullohet me akte nënligjore të miratuara nga Qeveria pas propozimit të Ministrit, që do të hartohet në përputhje me legjislacionin në fuqi që ndërlidhet me Universitetin dhe me këtë Ligj.</p> <p>4. Asgjë në këtë Ligj dhe në aktet nënligjore në fuqi të nxjerra sipas tij apo në dispozitat e çfarëdo ligji tjetër, nuk do të kufizoj kompetencat e zgjeruara të Komunës së Mitrovicës së Veriut.</p> | <p>which will be reviewed by an independent commission.</p> <p>3. Development of higher education at the University of North Mitrovica is regulated by sub-legal acts approved by the Government upon the proposal of the Minister, which will be drafted in accordance with the applicable laws related to the University and with this Law.</p> <p>4. Nothing in this Law and in applicable sub-legal acts issued under it, or in provisions of any other law, will limit the enhanced competences of Municipality of North Mitrovica.</p> | <p>jedne nezavisne komisije.</p> <p>3. Razvoj visokog obrazovanja na Univerzitetu u Severnoj Mitrovici je regulisan podzakonskim aktima usvojenih od strane Vlade na predlog ministra, koji će biti izrađeni u skladu sa važećim zakonima koji se odnose na Univerzitetu i sa ovim zakonom.</p> <p>4. Ništa u ovom Zakonu i važećim podzakonskim aktima donetim na osnovu njega, ili u odredbama bilo kojeg drugog zakona, neće ograničiti proširene nadležnosti Opštine u Severnoj Mitrovici.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 51 Aktet nënligjore</p> | <p style="text-align: center;">Article 51 Sub-legal acts</p> | <p style="text-align: center;">Član 51 Podzakonski akti</p> |
| <p>1. Qeveria dhe Ministri kanë autoritetin të miratojnë aktet nënligjore me qëllim të zbatimit të këtij Ligji.</p> <p>2. Qeveria dhe Ministri miratojnë aktet nënligjore për zbatimin e këtij Ligji, më së largu një (1) vit pas hyrjes në fuqi të Ligjit.</p> <p>3. Institucionet e arsimit të lartë duhet të hartojnë të gjitha aktet e tyre në përputhje</p> | <p>1. Government and the Minister have the authority to adopt sub-legal acts for the purpose of implementing this Law.</p> <p>2. Government and the Minister adopt the sub-legal acts for implementation of this Law, not later than one (1) year after the entry into force of the Law.</p> <p>3. Higher education institutions should draft all their acts in accordance with the</p> | <p>1. Vlada i ministar imaju ovlašćenje da usvoje podzakonske akte u cilju sprovođenja ovog Zakona.</p> <p>2. Vlada i ministar usvajaju podzakonske akte za sprovođenje ovog Zakona, najkasnije u roku od jedne (1) godine nakon stupanja na snagu Zakona.</p> <p>3. Institucije visokog obrazovanja treba da izrade sve svoje akte u skladu sa</p> |

| | | |
|--|--|--|
| <p>me dispozitat e këtij Ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi që nxirret në zbatim të këtij Ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 52 Dispozitat kalimtare</p> <p>1. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë duhet që t'i harmonizojnë statutet dhe rregulloret e tyre me dispozitat e këtij Ligji brenda një periudhe kohore jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji.</p> <p>2. Të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë që janë themeluar para hyrjes në fuqi të këtij Ligji dhe të cilët nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara me këtë Ligj lidhur me llojin dhe emërtimin e tyre do të kenë pesë (5) vite afat për të përshtatur dhe riorganizuar veten dhe programet e tyre në përputhje me përcaktimet e këtij Ligji mbi llojet e institucioneve të arsimit të lartë, emërtimin e tyre dhe programet e tyre të studimit.</p> <p>3. Zgjedhjet e reja për organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë duhet të zhvillohen në përfundim të mandatit të autoriteteve dhe organeve ekzistuese dhe sipas përcaktimeve të këtij Ligji.</p> | <p>provisions of this Law and the relevant applicable laws issued for implementation of this Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 52 Transitional provisions</p> <p>1. All higher education institutions should harmonize their statutes and regulations with provisions of this Law within a time period no later than six (6) months after entry into force of this Law.</p> <p>2. All public higher education institutions that were established before the entry into force of this Law and do not meet the criteria defined in this Law related to their type and denomination will have five (5) years to adapt and reorganize themselves and their programs in accordance with the specifications of this Law on the types of higher education institutions, their denomination and their study programs.</p> <p>3. New elections for the steering bodies in public institutions of higher education shall be held at the end of the mandate of existing bodies and authorities and in accordance with this Law.</p> | <p>odredbama ovog Zakona i odgovarajućim važećim zakonima donetim za sprovođenje ovog Zakona.</p> <p style="text-align: center;">Article 52 Prelazne odredbe</p> <p>1. Sve institucije visokog obrazovanja treba da usklade svoje statute i uredbe sa odredbama ovog Zakona u roku ne kasnije od šest (6) meseci od dana stupanja na snagu ovog Zakona.</p> <p>2. Sve javne institucije visokog obrazovanja koje su osnovane pre stupanja na snagu ovog Zakona, a ne ispunjavaju kriterijume definisane u ovom Zakonu koji se odnosi na njihovu vrstu i denominaciju će imati pet (5) godina da se prilagode i reorganizuju sebe i svoje programe u skladu sa specifikacijama ovog Zakona o vrstama institucija visokog obrazovanja, njihovu denominaciju i njihovih programa studija.</p> <p>3. Novi izbori za upravne organe u javnim institucijama visokog obrazovanja biće održani krajem mandata postojećih organa i vlasti u skladu sa ovim Zakonom.</p> |
|--|--|--|

| | | |
|--|---|--|
| <p>4. Pranimi i kandidatëve në institucionet e arsimit të lartë në vitin akademik 2016/2017 e në vijim, në të gjitha programet e studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, kryhet sipas përcaktimeve të këtij Ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 53 Zbatimi i Ligjit për procedurën administrative</p> <p>Nëse me këtë Ligj nuk përcaktohet ndryshe, për procedurën e punës në institucionet e arsimit të lartë, zbatohen dispozitat e ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.</p> <p style="text-align: center;">Neni 54 Shfuqizimi</p> <p>1. Ky Ligj shfuqizon:</p> <p>1.1. Ligjin nr. 04/L-037 për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare nr. 14, 9 shtator 2011), dhe</p> <p>1.2. Çdo dispozitë të legjislacionit që bie në kundërshtim me këtë Ligj e që ka të bëjë me arsimin e lartë.</p> | <p>4. Admission of candidates in higher education institutions for the academic year 2016/2017 onwards in all study programs provided from higher education institutions is carried out according to this Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 53 Implementation of the Law on administrative procedure</p> <p>Unless this Law otherwise specifies it, the provisions of the law on general administrative procedure are applicable for the work procedure at higher education institutions.</p> <p style="text-align: center;">Article 54 Repeal</p> <p>1. This Law repeals:</p> <p>1.1. Law no. 04/L-037 on higher education (Official Gazette no. 14, 9 September 2011), and</p> <p>1.2. Any provision that is inconsistent with this Law that relates to the higher education.</p> | <p>4. Prijem kandidata u institucijama visokog obrazovanja za akademsku godinu 2016/2017 i nadalje u svim programima studija pružanih od strane Institucija visokog obrazovanja vrši se u skladu sa ovim Zakonom.</p> <p style="text-align: center;">Član 53 Primenjivanje Zakona u upravnom postupku</p> <p>Ukoliko ovim Zakonom nije drukčije precizirano, odredbe zakona o opštem upravnom postupku važe za postupak rada u instituciji visokog obrazovanja.</p> <p style="text-align: center;">Član 54 Stavljanje van snage</p> <p>1. Ovaj Zakon stavlja van snage:</p> <p>1.1. Zakon br. 04/L-037 o visokom obrazovanju (Službeni list, br. 14, 9. septembar 2011), i</p> <p>1.2. Bilo koju odredbu koja je u suprotnosti sa ovim zakonom a koja se odnosi na visoko obrazovanje.</p> |
|--|---|--|

| | | |
|--|--|---|
| <p style="text-align: center;">Neni 55 Hyrja në fuqi</p> <p>Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: center;">Kadri Veseli</p> <hr style="width: 20%; margin: auto;"/> <p style="text-align: center;">Kryetar i Kuvendit të Replubikes së Kosovës</p> | <p style="text-align: center;">Article 55 Entry into force</p> <p>This Law enters into force fifteen (15) days after publication in the official gazette of the Republic of Kosova.</p> <p style="text-align: center;">Kadri Veseli</p> <hr style="width: 20%; margin: auto;"/> <p style="text-align: center;">The President of the Assembly of the Republic of Kosovo</p> | <p style="text-align: center;">Član 55 Stupanje na snagu</p> <p>Ovaj Zakon stupa na snagu petnaest (15) dana od dana objavljivanja u Službenom listu Republike Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Kadri Veseli</p> <hr style="width: 20%; margin: auto;"/> <p style="text-align: center;">Predsednik Skupštine Republike Kosovo</p> |
|--|--|---|